



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në:

Kontabilitet Financë

Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Dr. Ingrid Shuli (Bucka)

Prof. Dr. Dorina Kripa

Korrik / 2024

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Bachelor në “Kontabilitet-Financë”**

1	IAL aplikues:	Universiteti “Eqrem Cabej”, Gjirokastrë
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti Kontabilitet - Financë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në Kontabilitet - Financë
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 631, datë 23.09.1996
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Vendim Senati Nr. 1, datë 24.02.2010
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër MASH Nr. 334, datë 13.07.2011
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i Parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike / 6 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të Plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6 (gjashtë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit: viti akademik 2022-2023	7 PAE / 4 PAK
18	Numri i studentëve:	Viti 2020-2021 – 37 studentë Viti 2021-2022 – 36 studentë Viti 2022-2023 – 35 Studentë
19	Komente / të tjera:	-



PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti i Gjirokastrës “Eqerem Çabej” (UGJ) është një institucion publik i arsimit të lartë, i themeluar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.414 dt.12.11.1991, bazuar në Institutin e Lartë Pedagogjik të themeluar në vitin 1971. UGJ i është akorduar akreditimi institucional me Vendim Nr. 55, datë 16.12.2021 të Bordit të Akreditimit të ASCAL, me kohëzgjatje 4 vite akademike, afati vlefshmërisë deri më 15.12.2025. Universiteti “Eqerem Çabej” i Gjirokastrës sipas strukturës aktuale ka në përbërjen e tij tre fakultete emërtuar si vijon:

1. Fakulteti i Shkencave Natyrore;
2. Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore;
3. Fakulteti Ekonomik;

Në historinë e UGJ, Fakulteti Ekonomik dhe njësitë bazë të tij, janë hapur me vendimin Nr. 126, dt. 20.03.2017 të Ministrisë së Arsimit. Fakulteti Ekonomik si njësi kryesore brenda UGJ, ka në përbërje të tij, njësitë bazë si më poshtë vijon:

- Departamenti i Kontabilitet Financës;
- Departamenti i Administrimit Publik;
- Departamenti i Politikave Ekonomike dhe Turizëm;

Departamenti i Kontabilitet Financës, si pasardhës i Departamentit Ekonomik, i cili është hapur në vitin 1996 ofron aktualisht tre programe studimi: Bachelor në Kontabilitet Financë; Master Profesional në Kontabilitet Financë dhe Master i Shkencave në Financë Kontabilitet.

Programi i studimit Bachelor në Kontabilitet Financë që con drejt marrjes së Diplomës Bachelor në Kontabilitet Financë synon përgatitjen e specialistëve me njeohuritë bazë në fushën e kontabilitetit të financës, i aftëson studentët për tregun e punës dhe i përgatit për të avancuar më tej në karrierë. Ky është akreditimi i parë që do të krijojë mundësinë për përmirësime në vijim, në përputhje të Ligjit Nr.80/2015 të Arsimit të Lartë, udhëzimet që pasuan atë, si dhe Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve.

Programi, është konceptuar dhe hartuar me lëndë dhe module, përmban 180 ECTS dhe zhvillohet në tre vite të plota akademike.

Departmenti ka në përbërje 7 pedagogë të brendshëm nga të cilët: 1 me titullin “Profesor i Asociuar” dhe 6 Doktor shkencash, duke plotësuar kriteret ligjore.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

ASCAL, bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga Institucioni, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje: **Prof. Dr. Ingrid Shuli** dhe **Prof. Dr. Dorina Kripa**. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga koordinatoreja teknike e ASCAL, Znj. Majlinda Demirneli.

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit Bachelor në “Financë Kontabilitet”, i ofruar nga Departamenti i Kontabilitet Financës të Fakultetit të Ekonomik pranë Universitetit të Gjirokastrës, filloi me prezantimin, si dhe ndarjen e punës ndërmjet ekspertëve të grupit të vlerësimit të jashtëm. Më pas ky grup, bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga e-ASCAL, filloi shqyrtimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, si dhe dokumentet përkatëse në mbështetje të tij. Gjatë kësaj faze u identifikuan dhe u listuan një sërë pyetjesh, që kishin lidhje me standardet dhe kriteret përkatëse, të cilat do të mermin përgjigje gjatë takimeve që do të realizoheshin në IAL.

Vizita në FEUGJ, u realizua në datën 8 dhe 9 Nëntor 2023, ku Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, realizoi takimet e përcaktuara sipas agjendës së vizitës në IAL. Gjatë vizitës, në FEUGJ, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) zhvilloi takime me: Përgjegjësen e Departamentit të Kontabilitet Financës dhe Dekanin e Fakultetit të Ekonomisë, Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, stafin akademik të programit të studimit, stafin e njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë, Zyrën e Burimeve Njerëzore, përfaqësues të Zyrës së Karrierës dhe Alumnit, si dhe me Sekretarinë mësimore.

GVJ zhvilloi gjithashtu intervista me studentët e programit, vizitoi Bibliotekën e Institucionit si dhe vëzhgoi mjediset e institucionit si: auditorë, laboratorë, shërbimet për studentët, etj. Gjatë takimeve të realizuara sipas agjendës, u shqyrtuan çështje të ndryshme që lidhen me vlerësimin e programit të studimit Bachelor në Kontabilitet Financë, duke sqaruar edhe elementë të veçantë, për të cilat ekspertët kanë drejtuar pyetjet përkatëse.

Pas vizitës në IAL, GVJ hartoi raportin e vlerësimit të jashtëm, bazuar në dokumentacionin në dispozicion nga dosja e vlerësimit të brendshëm, informacioni i depozituar në sistemin e informacionit të ASCAL, si dhe në informacionin e mbledhur gjatë takimeve dhe vizitës të realizuar në Institucion. Në përfundim të këtij procesi ky grup dorëzon draft-raportin pranë ASCAL, si më poshtë vijon.

Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 31.05.2024, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 85/24 Prot, datë 31.05.2024. Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë njofton në ASCAL më datë 10.06.2024, me anë të shkresës me Nr.927/1 Prot, datë 06.06.2024 “Kthim përgjigje për Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit”, ku shprehin dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Kontabilitet Financë”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësish kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Institucioni i Arsimit të Lartë “Eqrem Cabej”, Gjirokastrë ka hartuar programe studimi që janë në shërbim të interesave kombëtare, duke u bazuar në kreun 1, neni 1 të Ligjit të Arsimit të Lartë, 80/2015. Në Strategjinë e Zhvillimit të Universitetit Eqrem Cabej, Gjirokastrë, theksohet se programet e studimit kanë për qëllim të përbashkët zhvillimin e arsimit, kulturës, shkencës dhe ekonomisë në shërbim të lirisë dhe diversitetit të ideve, për ndërtimin dhe konsolidimin e shoqërisë demokratike dhe shtetit të së drejtës, për rritjen e mirëqënies e dinjitetit njerëzor, të realizuara me veprimtari të ligjshme dhe transparente. Synimi mbetet, një sistem arsimor gjithëpërfshirës, që ofron mundësi të barabarta për të gjithë, duke respektuar, njëherazi, dallimet vetjake. Programi i studimit Bachelor Kontabilitet Financë është në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë Nr.80/2015, Strategjinë Kombëtare të Arsimit, Statutin e Universitetit “Eqrem Cabej”, Gjirokastrë dhe të gjithë bazën ligjore e nënligjore në fuqi. Ky program ka në qendër nevojat dhe interesat e studentëve, dhe mundëson përgatitjen e specialistëve të rinj në fushën e kontabilitetit dhe të financës, fusha këto me rëndësi publike, në shërbim të interesave kombëtare. <i>Evidenca 1.3 Strategjia e Zhvillimit të UGJ;</i> <i>Evidenca 1.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Cabej” Gjirokastrë;</i> <i>Evidenca 1.1.1 Urdhër i MASR për miratimin e Statutit;</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i Studimit Bachelor në Kontabilitet-Financë, sipas vizitës në institucion, dhe dokumentacionit përkatës, është ndërtuar në përputhje me qëllimet e misionin e UGJ, të shprehura në Statutin e UGJ, si dhe në Strategjinë e Zhvillimit të UGJ dhe në dokumenta të tjera të rëndësishme lidhur me këtë program studimi. Diploma që ofrohet nga ky program studimi është gjithashtu në përputhje me fushën e veprimtarisë. Qëllimi



	i programit të studimit gjykohet e vlerësohet për të qenë sa më afër zhvillimeve ekonomike-shoqërore të vendit, kërkesave të tregut për specialistë të fushës kontabilitet e financë, për t'i përgjigjur edhe zhvillimeve në fushën teknologjisë së informacionit, pjesë integrale e domosdoshme për aplikimin e këtyre disiplinave tashmë. <i>Evidenca 11.3 Strategjia e Zhvillimit të UGJ;</i> <i>Evidenca 1.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Cabej", Gjirokastër, Neni 2,4,5,8;</i> <i>Evidenca 1.19 Urdhëri i hapjes së njesisë kryesore;</i> <i>Evidenca 1.19.1 Riorganizimi në Kontabilitet Financë 2015;</i> <i>Evidenca 1.19.2 Vendimi i hapjes së programit të studimit Bachelor në Kontabilitet Financë;</i> <i>Evidencë 1.9 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Kontabilitet Financë, neni 3;</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimit akademike të tij.	Rezulton se programi i studimit Bachelor në Kontabilitet Financë është hapur qysh prej vitit 1996 dhe tashmë është pjesë e Fakultetit Ekonomik UGJ, sipas Vendimit të hapjes së Programit të studimit Bachelor Kontabilitet Financë. Ky program ofrohet nga njësia bazë Financë Kontabilitet dhe kurrikula e këtij programi është në përputhje të plotë me Strategjinë e zhvillimit të UGJ. Po kështu, programi është në përputhje e në zbatim të fushave dhe drejtimeve akademike të UGJ. Ky program studimi, sipas dokumenteve të rëndësishme si Statuti i UGJ, Rregullorja e UGJ, harton planin mësimor të çdo viti, si dhe programet apo syllabuset e lëndëve, në përputhje të plotë me kërkesat e tregut për të diplomuarit në Kontabilitet Financë, duke i përgatitur studentët të vijnë edukimin e kualifikimin e mëtejshëm në ciklin e dytë e të tretë të studimeve. <i>Evidenca 1.1 Statuti i UGJ, neni 62,63,65;</i> <i>Evidenca 1.3 Strategjia e Zhvillimit të UGJ;</i> <i>Evidenca 1.9 Rregullore e programit të studimit Bachelor Kontabilitet Financë;</i> <i>Evidenca 1.19.2 Vendimi i hapjes së programit të studimit Bachelor në Kontabilitet Financë, Nr 631, dt 23.09.1996;</i>
Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike	UGJ, i themeluar qysh në vitin 1971, ka përvojën dhe kapacitetet e nevojshme për ofrimin e programeve të studimit, pra ka kapacitetet e duhura në fushën akademike për të ofruar këtë program studimi Bachelor në Kontabilitet Financë. Referuar tabelës 1 për stafin akademik të FE si njësi kryesore e

specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	programit të studimit rezulton se kjo njësi në vitin akademik 2022-2023 ka në përbërje të saj 3(tre) departamente me 22 PAE dhe 10 PAK. <i>Evidenca 1.18 Vendim i hapjes së ILP;</i> <i>Evidenca 1.18.1 Vendim mbi krijimin e Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastrë;</i> <i>Evidenca 1.29 Angazhimi personelit akademik Nj.B.KF;</i>			
Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Programi i studimit Bachelor në Kontabilitet Financë sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve është program i nivelit 6 dhe është hartuar në përputhje të plotë me misionin e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë. Po kështu, fusha e përgjithshme dhe ajo specifike e këtij programi studimi është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Fakultetit Ekonomik, si edhe me fushën akademike e kërkimore shkencore të personelit akademik që zhvillon mësim në këtë program studimi. Në zbatim të Ligjit 80/2015 Njesia Bazë Kontabilitet Financë ka propozuar kodifikimin kombëtar të programit të studimit Bachelor Kontabilitet Financë, për aprovim nga MASR. <i>Evidenca 1.1 Statuti i UGJ, nent 5, 63;</i> <i>Evidenca 1.6 Strategjia e zhvillimit të Fakultetit Ekonomik;</i> <i>Evidenca 1.19.1 Riorganizimi në Kontabilitet Financë_2015;</i> <i>Evidenca 1.22 Përcjellja në MAS e propozimeve për kodifikimin e programeve;</i> <i>Evidenca 1.11.1 Pasqyrimi i propozimeve për kodifikimin e programeve të FE;</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> - UGJ e ofron programin e studimit në përputhje me misionin dhe qëllimin e deklaruar nga institucioni në Statutin e tij. - Ky program studimi ofrohet në fushat e veprimtarisë së institucionit dhe ka si synim ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare; - Programi i studimit paraqitet në përputhje me strategjinë e zhvillimit të institucionit dhe rregulloren e funksionimit të tij;			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X




Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiwe përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	UGJ në dokumentat e rëndësishme si Statuti i UGJ, Rregullorja e UGJ, evidenton ndarjen e detyrave institucionale të njësive brenda institucionit UGJ, Fakulteti Ekonomik, Njesia Bazë Kontabilitet Financë dhe krijimin e marrëdhënieve të mira mes tyre për të siguruar ecurinë e programit të studimit. I gjithë institucioni është i organizuar në funksion të realizimit të të gjithë elementëve të programit të studimit. Sipas organigramës së UGJ rezultojn se Njesia Bazë Kontabilitet Financë bashkëpunon me njësiti bazë të Fakultetit Ekonomik si: Njesia Bazë e Administrimit Publik dhe Njesia Bazë e Politikave Ekonomike dhe Turizmit, por bashkëpunon edhe me Fakultetin e Edukimit dhe Shkencave Shoqerore si dhe me Fakultetin e Shkencave te Natyres. Në analizën vjetore të secilës prej këtyre njësive, paraqitet veprimtaria akademike, ndihmës akademike dhe administrative-financiare. <i>Evidenca 1.1 Statuti i UGJ;</i> <i>Evidenca 1.2 Rregullore e UGJ, Kreu II,III,IV,V;</i> <i>Evidenca 1.14 Organigrama e UGJ;</i> <i>Evidenca 1.15 Organigrama e Fakultetit Ekonomik;</i> <i>Evidenca 1.16 Organigrama e Njesisë Bazë Kontabilitet Financë;</i> <i>Evidenca 1.29.2 Tabela treguese e angazhimit të personelit akademik Nj.B.K-F viti akademik 2021-2022;</i> <i>Aneks Tabelat për mbledhëse, Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës (Tabelat 12);</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë	Nga dokumentacioni i paraqitur rezultojn se UGJ ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi, në zbatim të strategjisë së UGJ, me universitete brenda e jashtë vendit, si dhe me institucione në nivel lokal, kombëtar e ndërkombëtar. Duke zbatuar këto marrëveshje bashkëpunimi, UGJ krijon mundësi për personelin akademik edhe për studentët për shkëmbime të eksperiencave më të mira, për leksione të hapura, për mundësi punësimi, për shkëmbime të stafëve akademike dhe të studentëve me universitete si brenda dhe jashtë vendit.

vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	<i>GVJ sugjeron që institucioni të intensifikojë punën për të rritur bashkëpunimet me IAL të tjera brenda e jashtë vendit por edhe me biznese, institucione publike dhe private.</i> <i>Evidenca 1.3 Strategjia e Zhvillimit të Universitetit “Eqrem Cabej” Gjirokastrë 2020-2025, fq 32;</i> <i>Evidenca 1.23 Lista e Marrëveshjeve të Bashkëpunimit të UGJ;</i> <i>Evidenca 1.24 Lista e projekteve të UGJ;</i> <i>Evidenca 1.25 Lista e mobiliteteve të UGJ;</i> <i>Evidenca 1.26 Leksione të hapura;</i> <i>Evidenca 1.11.6 Raporti vjetor I UGJ viti akademik 2021-2022;</i> <i>Evidenca 1.11.7 Vendim i Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit për miratimin e Raportit Vjetor 2021-2022;</i>
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	Nisur nga Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në Kontabilitet Financë, por edhe nga RVB e nga vizita në institucion, rezulton se Praktika Profesionale nuk është përfshirë si lëndë e detyrueshme apo me zgjedhje. <i>Evidencë II.1111 Plani mësimor Bachelor në Kontabilitet Financë 2021-2022;</i>
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Nga dokumentat dhe vizitat në institucionin UGJ, rezulton se në respekt të akteve ligjore e nënligjore kryhen analiza vjetore të veprimtarisë mësimore e shkencore në të cilat ze vend edhe përfitimi nga marrëveshjet e bashkëpunimit të UGJ, të Fakultetit të Ekonomisë me institucione, biznese, universitete, për përmirësimin e zbatimit të programit të studimit. <i>Evidencë 1.13.1 Raporti i veprimtarisë mësimore shkencore në Nj.B.K-F 2019-2020;</i> <i>Evidencë 1.13.2 Raporti i veprimtarisë mësimore shkencore në Nj.B.K-F 2020-2021;</i> <i>Evidencë 1.13.3 Raporti i veprimtarisë mësimore shkencore në Nj.B.K-F 2021-2022;</i>
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> <i>UGJ ka lidhur marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione akademiko-kërkimore në vend, por edhe të huaja.</i>



	<i>Institucioni duhet te intensifikoje punën për të rritur bashkëpunimet me IAL të tjera brenda e jashtë vendit por edhe me biznese, institucione publike dhe private.</i> <i>Në raportet vjetore të veprimtarisë mësimore dhe shkencore të UGJ, Fakultetit Ekonomik dhe Departamentit të Kontabilitet Financës analizohen marrëveshjet e bashkëpunimit në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit të stafit të angazhuar në këtë program studimi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Organizimi i programit të studimit, është kryer në përputhje me VKM 41, datë 24.01.2018, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL”, pika 2, me VKM nr.879, “Për disa ndryshime e shtesa në VKM 41, datë 24.01.2018 datë 18.12.2019 dhe VKM 185, dat 25.03.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr.41, datë 24.01.2018”. Program i studimit Bachelor në Kontabilitet Financë organizohet në lëndë ose module të vlerësuara me kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ETCS). Totali i krediteve (ETCS) është 180 ETCS, ku çdo vit studenti duhet të fitojë 60 kredite (ETCS). Kohëzgjatja është 3 vite akademike, me gjashtë semestra, forma e studimit me kohë të plotë, bazuar në suplementin e diplomës dhe në rregulloren e programit të studimit. Forma e studimeve është me kohë të plotë dhe gjuha e mësimdhënies është gjuha shqipe. Në përfundim të programit

	të studimit, ofrohet Diploma Universitare Bachelor në Kontabilitet Financë. <i>Evidenca 1.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Cabej" Gjirokastrë, neni 11, pika 1;</i> <i>Evidenca 1.9 Rregullore e programit të studimit Bachelor në Kontabilitet Financë, neni 1, neni 6;</i> <i>Evidenca II.3 VKM 41, dat 24.01.2018;</i> <i>Evidenca II.3.1 VKM nr 879, datë 18.12.2019;</i> <i>Evidenca II.3.2 VKM 185, datë 25.03.2021;</i> <i>Evidenca II.1111 Plani mësimor i programit të studimit të programit Bachelor në Kontabilitet Financë;</i>
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Programi i studimit synon të realizojë formimin e shprehive të veçanta për shumë lloje profesionale e specialitetesh e mbështetur kjo procedurë në rregulloren e riorganizimit të programit të studimit. Synim i rëndësishëm për këtë program studimi është të rrisë kompetencat profesionale të studentëve. Këtij synimi i shërben edhe përmirësimi i syllabuseve të lëndëve, aktivitetet e ndryshme në shërbim të rritjes kompetencave profesionale, leksionet e hapura. Lektorët e këtij program studimi sjellin në auditor metoda innovative për të aftësuar studentët. Në përputhje me kuadrin e përgjithshëm të programit të studimit gjatë gjithë semestrave të studimit, studentët zhvillojnë lëndë bazë të detyrueshme, kombinuar me lëndët karakterizuese, dhe lëndë të tjera ndërdisiplinore dhe /ose integruese në një ose më shumë grupe disiplinash të ngjashme dhe/ose integruese me disiplinat karakterizuese, profile të programit dhe grup-lëndë me zgjedhje, ku i jepet rëndësi edhe lëndëve plotësuese. Në semestrin e fundit studentët realizojnë provim formimi apo temën e diplomës, në përputhje me Rregulloren e Programit të Studimit Bachelor Kontabilitet Financë. <i>Evidenca II.1111 Plani mësimor i programit të studimit të programit Bachelor në Kontabilitet Financë 2020-2021;</i> <i>Evidenca 1.9 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Kontabilitet Financë;</i>
Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese	Sipas dokumentave nga institucioni dhe vizitës në UGJ, konstatohet se ky program studimi parashikon ngarkesën në kredite për praktikën profesionale të studentëve, sipas VKM 41, pika 2.4 dhe mbështetur në planet mësimore dhe kurrikulat

duke grupuar lëndët/modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	e ndryshuara në vitin akademik 2021-2022, të miratuara në department. Në planin mësimor të programit të studimit është përcaktuar qartë klasifikimi i lëndëve dhe vlerësimi i tyre me kredite sipas tipologjisë së përcaktuar në VKM nr.41: ▪ Kategoria A - Lëndë Bazë me 36 ECTS zënë rreth 20% të krediteve (i njëjtë me kufirin maksimal - 20% të krediteve); ▪ Kategoria B - Lëndë Karakterizuese me 98 ECTS zënë rreth 54,4% të krediteve (brenda kufijve 50% - 55% të krediteve); ▪ Kategoria C - Lëndë Ndërdisciplinore me 23 ECTS zënë rreth 12,78% të krediteve (brenda kufijve 12% - 15% të krediteve); ▪ Kategoria D - Lëndë Plotësuese me 16 ECTS zënë rreth 8,89% të krediteve (nën kufirin 10%-15% të krediteve); ▪ Kategoria E – Detyrime Përmbyllëse me 7 ECTS zënë 3, 89% të krediteve (brenda kufijve 3% - 5% të krediteve); Kreditet e çdo disipline mësimore dhe veprimtarie formuese janë përlllogaritur duke mbajtur parasysh ngarkesën në orë mësimore në auditor, si dhe punën individuale që duhet kryer nga studenti për përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara në programin e lëndës. Pesë lëndë zhvillohen me 75 orë në auditor, njëzetë e dy lëndë me 60 orë në auditorë, dy lëndë me 45 orë në auditor, ndërsa për diplomën janë parashikuar 50 orë në auditor – në total për programin e studimit zhvillohen sipas planit mësimor 1835 orë në auditor. <i>Evidenca II.3 VKM 41, dat 24.01.2018;</i> <i>Evidenca II.3.1 VKM nr 879, datë 18.12.2019;</i> <i>Evidenca II.3.2 VKM 185, datë 25.03.2021;</i> <i>Aneks-Tabelat përmbledhëse. Planit mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese (A-E) (Tabela 9);</i>
Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Sipas RVB dhe vizitës në UGJ rezulton se Programi mësimor bachelor në Kontabilitet Financë në planin mësimor të tij nuk e përfshin lëndën e praktikës profesionale as si lëndë të detyrueshme e as me zgjedhje. Sipas Planit mësimor 2021-2022, dhe Rregullores së Programit të studimit Bachelor Kontabilitet Financë, detyrime përmbyllëse për këtë program studimi konsiderohet provimi i përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome, që vlerësohet me 7 kredite (ETCS). <i>Evidenca II.1111 Planit mësimor i programit të studimit të programit Bachelor në Kontabilitet Financë 2021-2022;</i>

	<i>Evidenca 1.9 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Kontabilitet Financë;</i>
Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Sipas Rregullores së studimeve në UGJ, forma e organizimit të studimeve në programin Bachelor Kontabilitet Financë është studim me kohë të plotë. Rregullorja e studimeve të UGJ, Rregullorja e Programit të studimit Bachelor Kontabilitet Financë, japin informacione të nevojshme për studentët, qoftë për kriteret e përgjithëshme dhe ato specifike të pranimi, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. UGJ zbaton politika të financimit të studentëve të shkëlqyer apo dhe të studentëve përfitues në bazë të kriterëve të veçanta të vendosura me aktet nënligjore. Këto forma financimi zbatohen përmes bursave apo dhe përjashtimit nga tarifat e studimit, në bazë të vendimeve të Bordit të Administrimit të GJ. <i>Evidenca 1.2 Rregullore e UGJ, neni 49, 61;</i> <i>Evidenca 1.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Cabej" Gjirokastrë, kreu IV;</i> <i>Evidenca 1.9 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Kontabilitet Financë, neni 4 e 5;</i> <i>Evidenca II.14 Vendime Bordi Administrimit për bursat dhe mbështetje për kategoritë e vecanta;</i> <i>Evidenca II.14.1 Kategoritë e vecanta që përjashtohen nga tarifat 2019-2020;</i> <i>Evidenca II.14.2 Lista e studentëve me aftësi të kufizuara;</i> <i>Evidenca II.14.3 Konfirmim për frekuentimin e studentëve për bursa, NJBK-F;</i>
Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Sipas dokumenteve dhe vizitës në UGJ rezulton se programi i studimit Bachelor në Kontabilitet Financë që zhvillohet në UGJ, i është referuar dhe është mbështetur në masën 70% në programe studimi me të njëjtën emërtesë dhe që ofrohen në të njëjtën fushë studimi si edhe në universitete të tjera publike në Shqipëri. <i>Evidenca 4 RVB Bachelor Kontabilitet Financë UGJ;</i>
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Në zbatim të legjislacionit në fuqi, pra në Ligjin 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në RSH", neni 86 dhe në VKM nr.310, dat 11.05.2022 "Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë në RSH, njesia Bazë e Kontabilitet Financë, UGJ ka propozuar kodifikimin kombëtar të programit të studimit Bachelor Kontabilitet Financë. Sipas RVB është ende në pritje të aprovimit nga MASR të

Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	kodifikimit, për të vijuar më tej me kodifikimin e lëndëve të programit të studimit. <i>Evidenca 1.22 Përcjellja në MASR e propozimeve për kodifikimin e programeve;</i> <i>Evidenca 1.22.1 Pasqyrimi i propozimeve për kodifikimin e programeve;</i>			
Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Sipas dokumentave e vizitës në UGJ, Njesia Bazë Kontabilitet Financë përgjegjëse për programin e studimit deri më tani nuk ka ndonjë program të përbashkët, por synon që në të ardhmen të hartojë programe të përbashkëta studimi me institucione vendase apo të huaja. <i>Duhet bërë përpjekje nga institucioni për të patur programe studimit të përbashkëta, të cilat shtojnë mundësitë e integritetit si për studentët edhe për personelin akademik.</i> <i>Evidenca 4 RVB Bachelor Kontabilitet Financë UGJ;</i>			
Konkluzione	GVJ konstaton se: <i>Programi i studimit është i organizuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.</i> <i>Ka ngjashmëri deri në 70% në emërtesë me programe të njejta të ofruara nga IAL të tjera në vendin tone</i> <i>Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. NJBKF është në pritje të aprovimit të kodit të programit studimit nga MASR.</i> <i>Duhet bërë përpjekje nga institucioni për të patur programe studimit të përbashkëta, të cilat shtojnë mundësitë e integritetit si për studentët edhe për personelin akademik.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.

Dokumentohet se Njësia Bazë Kontabilitet Financë është përgjegjëse për programin e studimit dhe i përmbush detyrimet ligjore e nënligjore sipas nenit 25, të Ligjit për Arsimin e Lartë e Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë” Nr. 80/2015.

Fakulteti Ekonomik përbëhet nga 3 njësi bazë (duke përmbushur përcaktimet ligjore përkatëse):

1. Departamenti i Administrimit Publik;
2. Departamenti i Kontabilitetit dhe Financës;
3. Departamenti i Politikave Ekonomike dhe Turizmit;

Fakulteti Ekonomik në UGJ, si njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimit ka angazhuar gjatë vitit 2022-2023 evidenton 22 pedagogë efektivë, 10 pedagogë me kontratë dhe 3 personel ndihmës akademik. Sipas Statutit të UGJ,

Bazuar në dokumentacionin e aplikimit nga institucioni shikojmë se gjatë 2 viteve të fundit DKF si njësia bazë përgjegjëse e programit plotëson kërkesat ligjore dhe nënligjore lidhur me strukturën akademike dhe stafin akademik duke pasur një numër të qëndrueshëm stafi por në kufirin minimal të kërkuar, si më poshtë për vitet akademike:

Tituj/ grada	2021-2022		2022-2023	
	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	-	-	-	-
Prof. Asoc.	1	1	1	1
Dr./PhD.	6	-	6	-
Msc.	-	-	-	-
Totali	7	1	7	1

GVJ konstaton se numri i personelit akademik ka ardhur duke u ulur, kryesisht për shkak të angazhimit të një numri më të vogël të personelit PAK. Por, kemi rritje në numrin e personelit akademik me tituj e grada, konkretisht nga Doktor në Prof.Asoc.

GVJ sugjeron, që Njësia Bazë Kontabilitet Financë duhet të bëjë përpjekje për angazhimin e një numri më të madh pedagogësh nga kategoria “Profesor”.

Evidenca I.1 Statuti i UGJ;

*Evidenca 1.5 Rregullore e Fakultetit Ekonomik, neni 5;
Evidenca 1.19 Urdhër për hapjen e njesisë kryesore FE;
Evidencë 1.19.1 Riorganizimi i Kontabilitet Financë 2015;*

	<i>Evidenca 1.1.19.1 Vendim i hapjes së Programit të Studimit Bachelor Kontabilitet Financë;</i> <i>Evidenca 4 RVB Bachelor Kontabilitet Financë UGJ; Evidenca 4.1 Aneks RVB;</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Dokumentohet se njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit, për realizimin e këtij programi angazhon personel ndihmës akademik e administrativ. Kjo në bazë të rregullores së Njesisë Bazë Kontabilitet Financë dhe në rregulloren e programit të studimit. Sipas këtyre dokumentave, krahas kooordinatorit të programit të studimit, njësia kryesore dhe njësia bazë mbështeten edhe tek personeli ndihmës akademik/administrative, përmes asistentes së Njesisë Bazë Kontabilitet Financë, sekretarisë mësimore dhe laborantëve, të cilët janë të angazhuar në nivel njësie kryesore. Bazuar në dokumentacionin shoqërues të RVB, Fakulteti Ekonomik: • FE gjatë vitit 2020-2021 ka angazhuar gjithsej 1 personel ndihmës akademik, për njësinë bazë Kontabilitet Financë; • FE gjatë vitit 2021-2022 ka angazhuar gjithsej 1 personel ndihmës akademik, për njësinë bazë Kontabilitet Financë; • FE gjatë vitit 2022-2023 ka angazhuar gjithsej 1 personel ndihmës akademik, për njësinë bazë Kontabilitet Financë; <i>Evidenca 1.16 Organigrama e Njesisë Bazë Kontabilitet Financë;</i> <i>Evidenca 1.27 rregullore e punësimit të personelit akademik dhe administrativ, Nenet 7,8,9;</i> <i>Aneks Tabelat Përmbledhëse;</i> <i>Evidenca 4 RVB Bachelor Kontabilitet Financë UGJ; Evidenca 4.1 Aneks RVB;</i>
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e kooordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Në bazë të dokumentave dhe sipas vizitës në institucion konfirmohet se njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit, në bazë të legjislacionit në fuqi ka caktuar me vendim të njesisë bazë kooordinatorin e programit të studimit. Për programin e studimit Bachelor në Kontabilitet Financë, koordinatorë është përgjegjësja e njesisë bazë Kontabilitet Financë, që përfaqëson autoritetin drejtues të njesisë bazë. Koordinatori bashkëpunon, koordinon e monitoron me strukturat e tjera përgjegjëse mbarëvajtjen e ecurisë së zhvillimit të mësimi, merret me zgjidhjen e problemeve që dalin gjatë semestrit me studentët e personelit akademik, mban komunikim të vazhdueshëm me strukturat e njesisë bazë për informim të studentëve në lidhje me programin e studimit dhe detyrimet përmbyllëse. si provimi i përgjithshëm apo diploma.

	Përsa i përket praktikave mësimore, në këtë program studimi nuk përfshihet lënda e praktikës mësimore në planin mësimor. <i>Evidenca II.1111 Plani mësimor Bachelor Kontabilitet Financë 2021-2022;</i> <i>Evidenca II.16 Raport vjetor i FE 2021-2022;</i> <i>Evidenca II.16.1 Raport vjetor i FE 2020-2021;</i> <i>Evidenca II.16.2 Raport vjetor i FE 2019-2020;</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> <i>Njësia kryesore - Fakulteti Ekonomik dhe njësia bazë – Departamenti i Kontabilitet Financë që janë përgjegjës për ofrimin e programit të studimit përmbushin standardet ligjore në fuqi lidhur me organizimin dhe strukturën e këtyre njësive.</i> <i>Personeli ndihmës akademik dhe administrativ në shërbim të programit të studimit të angazhuar në ndjekjen e mësimin dhe orëve laboratorike, ai është i anagzhuar në nivel departamenti dhe njësie kryesore.</i> <i>Njësia bazë organizohet në grupe mësimore, kërkimore e shkencore, dhe ka përcaktuar koordinatorët e programit të studimit.</i> <i>Njesia Bazë Kontabilitet Financë duhet të bëjë përpjekje për angazhimin e një numri më të madh pedagogësh nga kategoria "Profesor".</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën	Për këtë program studimi përgjegjëse është njësia bazë, Departamenti Kontabilitet Financë që disponon të gjithë informacionin e nevojshëm për organizimin e programit, për strukturën dhe përmbajtjen e tij. I gjithë informacioni rreth këtij programi qarkullon, ruhet, arshivohet në bazë të rregullores për përmbajtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në UGJ. Edhe në faqen zyrtare të UGJ mund të gjendet çdo informacion i vlefshëm për mirë funksionimin e

dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	këtij program studimi. Njësia kryesore dhe njësia bazë disponojnë rregulloret përkatëse, rregulloren e programit të studimit, planin mësimor, syllabuset dhe informacione të tjera të nevojshme për zhvillimin e programit të studimit. <i>Evidenca I.1 Statuti i UGJ;</i> <i>Evidencë 1.7 Rregullore e Njesisë Bazë Kontabilitet Financë;</i> <i>Evidenca 1.9 Rregullore e Programit të studimit Bachelor Kontabilitet Financë;</i> <i>Evidenca II.1111 Plani mësimor i Programit Studimit Bachelor KF 2021-2022;</i> <i>Evidenca II.28 Programet e lëndëve (syllabuset) e programit të studimit Bachelor KF;</i> <i>Evidenca II.16 Udhëzim nr 11 "Për përcaktimin e përmbajtjes dhe formës së Suplementit të Diplomës; Evidenca IV.2 Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale;</i>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Programi i studimit zhvillohet në gjuhën shqipe, në tre vite akademike të ndarë secili në dy semestra me kohëzgjatje normale 15 javë. Lëndët janë të ndara sipas kategorive referuar përcaktimeve ligjore. Kurrikula e programit të studimit përmban 30 lëndë nga të cilat në vitin e dytë dhe të tretë në planin mësimor parashikohet nga një lëndë me zgjedhje (studenti zgjedh 1 lëndë mes 4 lëndëve çdo vit). <u>Në vitin e parë</u> zhvillohen 10 lëndë; <u>Në vitin e dytë</u> zhvillohen 9 lëndë të detyrueshme dhe 1 lëndë me zgjedhje (studenti zgjedh një në 4 lëndë); <u>Në vitin e tretë</u> studenti zhvillon 8 lëndë të detyrueshme dhe një me zgjedhje (studenti zgjedh një në 4 lëndë). Në fund të vitit të tretë studenti zhvillon provimin e formimit ose mbron diplomën. Programi vlerësohet gjithsej me 180 kredite: • 5 lëndë/module vlerësohen me 7 kredite; • 18 lëndë vlerësohen me 6 kredite • 6 lëndë vlerësohen me 5 kredite; • Diploma që vlerësohet me 7 kredite. Për sa i përket orëve në auditor, program i studimit parashikon 1.835 orë në auditor, nga të cilat: • 615 orë në auditor gjatë vitit të parë; • 615 orë në auditor gjatë vitit të dytë.

	• 555 orë në auditor gjatë vitit të tretë, si dhe 50 orë për provimin e formimit apo diplomën. GVJ konstaton se ngarkesa në auditor është e balancuar dhe pothuajse uniforme midis semestrave. Plani mësimor parashikon edhe 830 orë jashtë auditorit në formën e detyrave/projekteve dhe punës individuale. Pra, programi i studimit parashikon në total 2665 orë mësimore gjithsej. <i>Evidenca I.1 Statuti i UGJ;</i> <i>Evidencë 1.7 Rregullore e Njesisë Bazë Kontabilitet Financë;</i> <i>Evidenca 1.9 Rregullore e Programit të studimit Bachelor Kontabilitet Financë;</i> <i>Evidenca II.1111 Plani mësimor i Programit Studimit Bachelor KF 2021-2022;</i>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimi, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Programi i studimit Bachelor Kontabilitet Financë, përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që synojnë këtë program studimi. Këto informacione kryesisht lidhen me kriteret e përgjithëshme e specifike të pranimi, kriteret e transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Institucioni bën njohjen e lëndëve sipas Rregullores së UGJ, neni 49, 61, 65 dhe kreut IV të Rregullores së Fakultetit Ekonomik, neni 17, neni 30. Në zbatim të Ligjit 80/2015 Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në RSH”, kriteret specifike si dhe kuotat e pranimi të studentëve i propozon Njesia Bazë tek drejtuesi i njesisë kryesore e më pas propozimi kalon në rektorat për miratim. <i>Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Cabej” Gjirokastrë;</i> <i>Evidenca I.5 Rregullore e Fakultetit Ekonomik;</i> <i>Evidenca II.10.1 Kuotat e propozuara të pranimi të studentëve 2020-2021;</i> <i>Evidenca II.11.1 Kuotat e propozuara të pranimi të studentëve 2021-2022;</i> <i>Evidenca II.13.1 Kuotat e propozuara të pranimi të studentëve 2022-2023;</i> <i>Evidenca II.20 Procedurë e transferimit të studentëve;</i>
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet	Dokumentohet se programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për syllabuset e lëndëve, ku përfshihet edhe ngarkesa mësimore në leksione e seminare. Disponon edhe informacion për gjithë komponentët formues të programit

lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara sipas VKM nr.41, datë 24.01.2018, VKM 879, datë 18.12.2019 dhe VKM nr.185, datë 25.03.2021. Mbi këtë bazë ligjore është hartuar edhe Plani mësimor i Bachelor Kontabilitet Financë 2021-2022. Neni 66 i Rregullores së UGJ paraqet elementet e programeve të studimit të ofruara nga UGJ, të vlefshme edhe për programin e studimit Bachelor Kontabilitet Financë. Në përgjithësi syllabuset janë të unifikuara për sa i përket objektivave, temave të lëndës së bashku me çështjet për secilën temë, vlerësimin e studentit dhe literaturën bazë dhe të detyrueshme. <i>Evidenca II.3 VKM 41, dat 24.01.2018;</i> <i>Evidenca II.3.1 VKM nr 879, datë 18.12.2019;</i> <i>Evidenca II.3.2 VKM 185, datë 25.03.2021;</i> <i>Evidenca II.1111 Plani mësimor Bachelor Kontabilitet Financë 2021-2022;</i> <i>Evidenca II.28 Programet lëndore (syllabuset) e programit të studimit Bachelor në Kontabilitet Financë 2022-2023;</i>
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Sipas vizitës në institucion dhe dokumentacionit mbështetës, ky program studimi është në përmirësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik njesia bazë propozon deri në miratimin e tyre nga njesia kryesore e nga Senati Akademik, ndryshimet e mundëshme dhe arkivohet dosja sipas legjislacionit në fuqi. Ky program studimi ka pësuar disa ndryshime, vecanërisht pas miratimit të ligjit 80/2015 “Për Arsimin e Lartë e Kërkimin Shkencor në RSH, neni 71 e 73 për organizimin e programeve të studimit. <i>Evidenca II.2 Vendim Senati Akademik për riorganizimin e planeve mësimore 2018-2019;</i> <i>Evidenca II.113 Vendim Senati Akademik për riorganizimin e planeve mësimore 2021-2022;</i> <i>Evidenca II.7.1 Dërgim në MAS të riorganizimit të planeve mësimore;</i>
Konkluzione	GVJ konstaton se: <i>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit disponon të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të</i>

	<i>studimit, i cili përmban elementet përkatëse të kërkuara në kuadrin ligjor.</i> <i>Kuadri rregullator i UGJ parashikon kriteret dhe procedurat e përgjithshme të pranimit të studentëve në programet e ciklit të parë, si dhe procedurat lidhur me ecurinë deri në diplomim, përfshirë vlerësimin e dijeve dhe mundësinë e transferimit në/nga programe të tjera dhe ekuivalentimit të studimeve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Për këtë program studimi, emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e ngarkesës mësimore sipas lëndëve dhe praktika mësimore si pjesë e programit, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive të studentëve për studime të mëtejshme apo punësim të tyre, në zbatim të VKM 41, datë 24.01.2018, VKM 879, datë 18.12.2019 dhe VKM 185, datë 25.03.2021. Në baz të këtyre akteve nënligjore është hartuar plani mësimor i këtij program studimi Bachelor Kontabilitet Financë i cili është kategorizuar në: - Lëndë bazë (A), që përcaktojnë formimin e përgjithshëm, përgatitjen metodologjike dhe kulturën e përgjithëshme në fushën e Kontabilitet Financë si: Hyrje në Ekonomi, Bazat e Marketingut, Bazat e Statistikës, Mikroekonomi, E Drejtë Biznesi, Historia e Ekonomisë; - Lëndë karakterizuese (B), që lidhen me vecoritë e programit të studimit dhe japin një formim specifik në fushën e kontabilitetit dhe Financës si: Bazat e Financës, Parimet e Kontabilitetit, Kontabilitet Financiar, Financat Publike, Hyrje në modelim financiar, Etika dhe komunikimi në biznes, Drejtim financiar. Kontabilitet Kosto, Investime, Kontabilitet Drejtimi, Kontabilitet Publik, Njohuri mbi sistemin e Tatim Taksave, manaxhim Operacional, Makroekonomi, Manaxhim i Burimeve Njerezore, Manaxhim Biznesi;

	- Lëndë ndërdisiplinore dhe /ose integruese (C) në një ose më shumë grupe disiplinash, të ngjashme dhe/ose integruese me disiplinat karakterizuese dhe grup lëndë me zgjedhje: Matematikë financiare, Statistikë e zbatuar, Shkrim dhe manaxhim projektesh, Manaxhim i biznesit të vogël, Ekonomi monetare, Shkrim akademik, Kontabilitet nacional, Financa nacionale, Kontabilitet Bankar dhe Kontabiliteti i shoqerive të sigurimeve; - Lëndë plotësuese (D), të fokusuara në përfitimin e aftësive në gjuhë të huaj, aftësive informatike dhe telematike, aftësive komunikuese dhe prezantuese, aftësive që lehtësojnë hyrjen në tregun e punës si: Informatikë, Gjuhë e huaj dhe Kompjuterizim kontabël; - Detyrime përmbyllëse (E) që lidhen me përgatitjen e temës së dolojmës apo me provimin e përgjithshëm përfundimtar; Në përfundim të tre viteve të studimit, studentët pajisen me diplomë Kontabilitet Financë, pasi kanë marrë një formim bazë në fushën e Kontabilitetit e Financës, i cili do u shërbejë për kualifikim të mëtijshëm në ciklin e dytë dhe të tretë të studimeve në të njëjtën fushë apo në programe të tjera integruese, do u shërbejë edhe për punësimin e tyre si në sektorin privat edhe në atë publik. <i>Evidenca II.3 VKM 41, dat 24.01.2018;</i> <i>Evidenca II.3.1 VKM nr 879, datë 18.12.2019;</i> <i>Evidenca II.3.2 VKM 185, datë 25.03.2021;</i> <i>Evidenca II.1111 Plani mësimor Bachelor Kontabilitet Financë 2021-2022;</i> <i>Evidenca II.28 Programet lëndore (syllabuset) e programit të studimit Bachelor në Kontabilitet Financë 2022-2023;</i> <i>Evidenca II.18 Dabazë Alumni;</i> <i>Evidenca II.23 Informacion mbi analizën e përshtatshmërisë së kurrikulave në UGJ;</i>
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe	Konstatohet nga dokumentacioni se lëndët/modulet shpërndarja në vite akademike e semestra, vlerësimi i lëndëve në kredite e orë mësimore, orë në auditor e punë individuale e studentëve, mundësojnë realizimin e objektivave formues të programit të studimit dhe të rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimit profesional. Nga shqyrtimi i planit mësimor dhe programeve lëndore, GVJ konstaton se shpërndarja e ngarkesës mësimore në semestra sipas lëndëve dhe moduleve është përgjithësisht e balancuar dhe mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit si dhe të rezultateve të

rezultateve të pritshme të të nxënit.	pritshme të të nxënit dhe aftësimit profesional në fushën kontabilitet e financë. Vlerësimi në kredite i lëndëve në secilën kategori është në përputhje me fokusin e çdo lënde, si dhe pesha e lëndëve për secilën kategori është në përputhje me kriteret e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në planin mësimor lëndët janë të shpërndara në vite akademike, në semestra, në fillim paraqiten lëndët bazë, pastaj lëndët formuese, duke respektuar nivelin e 25 orëve në javë bazuar në kurrikulën e programit të studimit. <i>Evidenca II.3 VKM 41, dat 24.01.2018;</i> <i>Evidenca II.3.1 VKM nr 879, datë 18.12.2019;</i> <i>Evidenca II.3.2 VKM 185, datë 25.03.2021;</i> <i>Evidenca II.1111 Plani mësimor Bachelor Kontabilitet Financë 2021-2022;</i>
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Sipas dokumentave dhe visitës në UGJ, Programi i studimit Bachelor në Kontabilitet Financë është hartuar bazuar edhe në programe të ngjashme brenda vendit, por edhe në programe studimi të ngjashme ndërkombëtare. Për këtë kanë ndihmuar shkëmbimet e eksperiencave mes fakulteteve brenda e jashtë vendit, projektet Erasmus+, po kështu kanë shërbyer eksperiencat e pedagogëve të cilët kanë ndjekur studimet e doktoraturës në këto universitete dhe sjelljes në UGJ të këtyre eksperiencave për përmirësimin e programit të studimit. Struktura e programit në tërësi respekton raportet teori, praktikë, pra orë mësimi në auditor, leksione, seminare, orë laboratorike dhe punë individuale e studentit. Nëse i referohemi Planit Mësimor, çdo semestër ka 30 kredite, pra ngarkesa e një viti është 60 kredite, e ngjashme kjo me praktikat ndërkombëtare. Për çdo lëndë zhvillohen 2 orë leksioni, 2 orë seminari, apo laborator, në javë, duke i kushtuar rëndësi rritjes së aftësive të studentit për zbatimin e njohurive të marra në leksion. Lëndët dhe emërtimi i tyre në tërësi janë në përputhje me profilin e këtij program, i cili i përket fushës së Shkencave Ekonomike. <i>Evidenca II.1111 Plani mësimor Bachelor Kontabilitet Financë 2021-2022;</i> <i>Evidenca II.28 Programet lëndore (syllabuset) e programit të studimit Bachelor Kontabilitet Financë 2022-2023; Evidenca II.5 Model Diplome Bachelor Kontabilitet Financë;</i> <i>Evidenca II.6.1 Format suplementi i diplomës Bachelor Kontabilitet Financë;</i>

Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Për këtë program studimi ndarja e elementeve të programit sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritje e realizim të objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitete dhe punësim në përfundim të studimeve, mbështetur në dosjen e riorganizimit të programit të studimit, e cila është hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi. Bazuar në kurrikulën e programit të studimit, ky program ndërthur formimin teorik të studentëve me formimin praktik. Referuar planit mësimor, ndarja e orëve në auditor në leksione dhe seminare është si më poshtë: - Leksione – 840 orë mësimore; - Seminare – 555 orë mësimore; - Ushtrime – 405 orë mësimore; Raporti Teori (leksione) / Praktikë (ushtrime/seminare) rezulton 840 orë teori / 960 orë praktikë ose afërsisht 47% / 53%. Studentëve të këtij program u ofrohen mundësi të kryejnë mobilitete në kuadrin e programeve Erasmus + por jo vetëm, duke qenë se veprimtaria formuese e këtij program është e ngjashme me programe të tjera të ngjashme në universitete të huaja. <i>Vërehet një diferencë prej 15 orë më tepër në planin mësimor të vitit të tretë 2021-2022, totali i orëve të lëndës me zgjedhje është shkruar 45 orë, ndërsa kur detajohet rezulton 30 orë leksion/15 orë seminare, dhe 15 orë ushtrime, pra në fakt janë evidentuar 60 orë për lëndën me zgjedhje. Kjo bën që të ndryshojë dhe totali i orëve të vitit të tretë.</i> <i>Evidenca II.1111 Plan mësimor Bachelor Kontabilitet Financë 2021-2022;</i> <i>Evidencë II.20 Procedurë transferimi të studentëve; Evidenca II.18 Databazë Alumni;</i> <i>Evidenca II.19 Të dhëna statistikore nga Zyra Alumni; Evidenca II.23 Informacion mbi analizën e përshtatshmërisë së kurrikulave në UGJ;</i> <i>Aneks Tabelat përmbledhëse. Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve (Tabela 21) Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve;</i>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të	Programet e lëndëve/modulet e programit të studimit, përditësohen vazhdimisht në departament. Miratohen nga Departamenti Kontabilitet Financë në fillim të vitit akademik. Programet e lëndëve janë ndërtuar në mënyrë të tillë që të

vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	pasqyrojnë ngarkesën semestrale të lëndës për 15 javë, të ndarë në orë leksioni, seminari, laboratorë, saktësojnë objektivat e lëndës, përfitimet nga lënda, me qëllim që studentët të marrin aftësitë e duhura profesionale, kompetencat e duhura, sipas kërkesave të tregut. Këto programe lëndësh përfshijnë edhe literaturën bazë, të detyrueshme edhe atë plotësuese. Në leksionin e parë të çdo lënde pedagogu informon studentët për të gjithë elementet e programit të lëndës, për mënyrën e vlerësimit të lëndës, për literaturën bazë dhe plotësuese që do shfrytëzojnë për përvetësimin e lëndës. Nga vizita në bibliotekë konstatohet se ka mungesa në tekste, ata nuk jan të 5 viteve të fundit. Gjatë takimit me stafin akademik të programit të studimit, GVJ konstatoi se pedagogët angazhohen që nëpërmjet rasteve studimorë, dhe punimeve/artikujve shkencorë t'u ofrojnë studentëve njohuri sa më aktuale dhe praktike në lëndët përkatëse. <i>Pas shqyrtimit të buxhetit dhe projekt/buxhetit të institucionit, GVJ konsaton se lidhur me përditësimin e titujve <u>nuk janë kryer shpenzime për blerje librash, por vetëm shpenzime për abonime në biblioteka online.</u></i> <i>Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Cabej", Gjirokastër, neni 26;</i> <i>Evidenca I.5 Rregullore e Fakultetit Ekonomik, neni 21;</i> <i>Evidenca II.28 Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Bachelor Kontabilitet Financë 2022-2023; Evidenca II.22 Miratimi i literaturës bazë në NJBK-F 2020-2021;</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Dokumentohet nga institucioni, se rezultatet e pritshme të të nxënit pas tre viteve të studimit, janë rritja e aftësive, e kompetencave, e mundësive për të gjetur punë në përputhje me shkollimin, mundësi për të vijuar më tej studimet. Një dokument i rëndësishëm që pasqyron këto përfitime është edhe suplementi i diplomës, i cili i jepet studentëve nga Fakulteti në përfundim të studimeve e diplomimit në dy gjuhë shqip e anglisht. Po kështu, një pasqyrim i mirë i rezultateve të pritëshme bëhet edhe në analizën e ecurisë së programit të studimit. Rezultatet e të nxënit maten përmes realizimit të objektivëve të lëndës, përfitimeve nga lënda, aftësive e kompetencave që pritet të përvetësojë studenti pas përfundimit të lëndës. <i>Evidenca II.1111 Plani mësimor Bachelor Kontabilitet Financë 2021-2022;</i>

	<i>Evidenca II.28 Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Bachelor Kontabilitet Financë 2022-2023; Evidenca II.6.1 Format suplementi i diplomës Bachelor Kontabilitet Financë;</i>			
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Programi i studimit ka përmbajtjen e duhur dhe u krijon studentëve mundësi për vijimësinë e mëtejshme të studimeve në programet e studimit të nivelit të dytë Master pranë Fakultetit Ekonomik apo edhe në universitete të tjera Publike e jopublike. <i>Evidenca II.18 Databaza Alumni;</i> <i>Evidenca II.19 Të dhëna statistikore nga Zyra e Alumni;</i> <i>Evidenca II.23 Informacion mbi analizën e përshtatshmërisë së kurrikulavë në UGJ;</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> <i>Përmbajtja e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, shpërndarja mes veprimtarive formuese, raporti teori-praktikë dhe ngarkesa në kredite janë në përputhje me profilin e programit të studimeve në fushën kontabilitetit e financës.</i> <i>Të saktësohen diferencat në planin mësimor të vitit të tretë 2021-2022, pasi kjo mund të ndikojë edhe në saktësimin e ngarkesës mësimore.</i> <i>Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuar sipas kërkesave të tregut të punës dhe mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve të thelluara në cikle studimi më të larta.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës,	Programi i studimit, ka për synim plotësimin e kërkesave të tregut për studentë të përgatitur për profesionin e kontabilistit e financierit. Studimi i tregut, panairët që zhvillohen në mënyrë të vazhdueshme, i shërbejnë këtij synimi. Institucioni ka lidhur marrëveshje si me institucione, me biznese, me qëllim që studentët të kenë mundësi të marrin informacion për këto

gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	mundësi edhe përmes aktiviteteve të përbashkëta që zhvillon institucioni UGJ. UGJ ka përmirësuar përmbajtjen e programit të studimit në përputhje me kërkesat e tregut, duke përmirësuar kurrikulat mësimore. <i>Evidenca II.3 Vendim Senati Akademik për lëndën Shkrim dhe Manaxhim projektsh;</i> <i>Evidenca II.15 Pjesmarrje në Panairin Work and Study 2022;</i> <i>Evidenca II.15.1 Pjesmarrje në Panairin Work and Study 2023;</i> <i>Evidenca II.32 Përfshija në trainime, mobilitete dhe projekte të stafit akademik të FE;</i>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Dokumentohet se UGJ nxit e garanton përfshirjen e studentëve në vendimarrje. Studentët janë angazhuar në Senatin Akademik të UGJ, janë të përfshirë në Këshillin Studentor të UGJ dhe kanë Statutin në bërë të të cilit funksionon ky këshill. Përmes zyrës Alumni, Këshillimit të karrierës dhe Vlerësimit të vazhduar, UGJ mban kontakte me studentët e diplomuar, konsultohet me ta për përmirësimin e programit të studimit, pasi ata sjellin eksperiencat e tyre të punës të vlefshme për t'i pasqyruar në programet e lëndëve dhe në programin e studimit në tërësi. Studentët vlerësojnë procesin akademik përmes plotësimit të pyetësorëve drejtuar atyre nga Sektori i Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave, ndihmon institucionin të përmirësojë cilësinë. Në zbatim të legjislacionit në fuqi UGJ, Fakulteti Ekonomik, në kuadrin e programit të studimit ka ngritur dhe ka funksional Njesinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë si strukturë më vete paralele me Sektorin e Standarteve dhe Kurrikulave, ka hartuar Manualin e Cilësisë, duke zbatuar strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, pra duke përfshirë studentët dhe bashkëpunëtorë ekspertë të jashtëm (për GVB), sipas rregullores së NJSBC. <i>Evidenca II.1.1 Lista e anëtarëve të Senatit Akademik;</i> <i>Evidenca II.25.1 Lista e anëtarëve të Këshillit Studentor;</i> <i>Evidenca II.25 Statuti i Këshillit Studentor;</i> <i>Evidenca II.23 Informacion mbi analizën e përshtatshmërisë së kurrikulave në UGJ;</i> <i>Evidenca VI.1 Manuali i cilësisë në UGJ; Evidenca 6 Rregullore e NJSBC;</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në	Njësia Bazë Kontabilitet Financë në bashkëpunim me institucione publike e private, me studentët Alumni të viteve të kaluara, merr parasysh propozimet e tyre për përmirësim e

përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	përditësim të programeve mësimore, të programit të studimit, për t'iu përgjigjur kërkesave të tregut. Pjesë e personelit akademik të NJBKF është pjesë e strukturave vendimmarrëse e konsultuese të institucioneve e organizatave publike e private, me të cilët bashkëpunojnë, dhe sjellin në auditore e pasqyrojnë në programin e studimit të rejtat dhe propozimet e bëra edhe prej këtyre partnerëve e bashkëpunëtorëve. <i>Evidenca II.31 Vendim Senati akademik për lëndën Shkrim dhe manaxhim projektsh;</i> <i>Evidenca I.23 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të UGJ;</i> <i>Evidenca I.24 Lista e projekteve të UGJ;</i> <i>Evidenca I.25 Lista e mobiliteteve të UGJ;</i>			
Konkluzione	UGJ është i angazhuar në një program të vazhdueshëm të përmirësimit të kurrikulave të të gjitha programeve që ai ofron duke reflektuar opinione të paleve të përfshira, si studentët dhe përfaqësues të institucioneve e organizatave publike e private. Institucioni angazhohet që të përmirësojë programin e studimit nëpërmjet bashkëpunimit me aktorë të tregut, në mënyrë që të garantohet një proces serioz dhe cilësor i hartimit/rishikimit të kurrikulave të programit të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1

Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënës, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Bazuar në dokumente si: Rregullore e studimeve të UGJ, Rregullore e Fakultetit Ekonomik, Rregullore e Njesisë Bazë Kontabilitet Financë, dhe në planin mësimor Bachelor Kontabilitet Financë, ngarkesa ndahet në leksione, seminare, laboratorë. Zbatohen forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale të zhvilluara në auditor, leksionet e hapura dhe çdo formë tjetër e mësimdhënies e miratuar nga institucioni, UGJ. Në programin e lëndës specifikohen edhe detyrimet e studentit për të shlyer lëndën si test i ndërmjetëm, provim përfundimtar, detyrë apo projekt kursi, të gjitha në shërbim të transmetimit të dijeve e njohurive tek studentët. <i>Evidenca I.2 Rregullore e UGJ, neni 70;</i> <i>Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në UGJ, neni 22;</i> <i>Evidenca I.5 Rregullore e Fakultetit Ekonomik;</i> <i>Evidenca II.1111 Plani mësimor Bachelor Kontabilitet Financë 2021-2022;</i> <i>Evidenca II.28 Programet e lëndëve të proramit të studimit Bachelor Kontabilitet Financë 2022-2023;</i>
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	UGJ, përmes programit të studimit, ofron kurrikul në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe të përshtatur me kushtet e tregut. Procesi i mësimdhënies kryhet nga ana e personelit akademik duke përdorur metoda alternative mësimdhënie e mësimnxënie, duke iu përgjigjur nevojave e interesit të studentëve. Gjatë zhvillimit të lëndëve sipas planit mësimor, realizohen edhe leksione të hapura nga përfaqësues të institucioneve publike apo private, përfaqësues të biznesit, mësim në laboratore, seanca ushtrimesh e diskutimesh, si dhe prezantim i projekteve të kursit në grup. Gjatë periudhës së pandemisë, mësimi u zhvillua online përmes platformave elektronike të mësimit në distancë Microsoft Office 365, Microsoft Teams, Classroom, Edumet. UGJ mundësoi edhe trainime për përdorimin e këtyre platformave për personelin akademik, duke përgatitur edhe manual përdorimi për studentët. Departamenti Kontabilitet Financë monitoroi zhvillimin e mësimit online, përmes raportimeve nga vetë platforma dhe evidentimi i tyre me formularë përkatës për çdo lëndë e çdo lektor. Në planin mësimor të programit të studimit Bachelor Kontabilitet Financë përfshihet edhe veprimtaritë formuese, “lëndët me zgjedhje, veprimtari alternative të programit që u mundëson studentëve të përzgjedhin një lëndë mes një grupi lëndësh.



	<i>Evidenca 1.9 Rregullore e programit të studimit Bachelor Kontabilitet Financë;</i> <i>Evidenca III.5 Udhëzues mbi zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative në mësimdhënie;</i> <i>Evidenca III. 1 Urdhër për platformën e mësimi online;</i> <i>Evidenca III.1.1 Implementimi i platformës së mësimi online Classroom;</i> <i>Evidenca III.1.4 Manuali i përdorimit të platformës Teams për stafin akademik;</i> <i>Evidenca III.1.7 Rregullore për format e zhvillimit të provimeve 2020-2021;</i>
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxëniet.	Në UGJ personeli akademik i angazhuar në programin e studimit mban grada e tituj shkencorë, është me eksperiencë disa vjeçare e me përvojë në mësimdhënie si në universitete shtetërore dhe në ato private. Gjatë zhvillimit të orëve të leksionit e të seminareve, lektorët zhvillojnë mësimin në mënyrë interaktive, pra duke përfshirë edhe studentët në diskutim përmes pyetjeve që drejton lektori apo pedagogu në sallë dhe diskutimit në detaje të çështjes duke përfshirë edhe studentët në diskutim. UGJ mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxëniet përmes; përmirësimit të infrastrukturës së mësimdhënies, në auditorë të pajisur me teknologji bashkëkohore të mësimdhënies; laboratorëve për zhvillimin e disa lëndëve me karakter praktik si Kompjuterizimi kontabël; përmes mobiliteteve të personelit akademik, pjesëmarrjes në trainime e workshope, në kuadrin e projekteve me partner të huaj, me qëllim përsosjen e metodave të mësimdhënies. <i>Evidenca III.2 Inventari i mjeteve didaktike e laboratorike e teknologjike;</i> <i>Evidenca I.24. Lista e projekteve të UGJ;</i> <i>Evidenca I.25 Lista e mobiliteteve në UGJ;</i> <i>Evidenca III.5 Udhëzues mbi zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative në mësimdhënie;</i> <i>Evidenca III.1.4 Manuali i përdorimit të platformës Teams për stafin akademik;</i> <i>Evidenca III.9 Informacion për bibliotekën U-Library, Fondi i Librit;</i> <i>Evidenca III.9.1 Jstor Adresë elektronike online;</i>

Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Në UGJ personeli akademik i angazhuar në programin e studimit është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, brenda fushës së studimit Kontabilitet Financë, përmbush kërkesat ligjore në fuqi përsa i përket kualifikimit. Sipas dokumentacionit të paraqitur, për vitin akademik 2022-2023, personeli akademik i NJBKF përbëhet nga 7 shtatë personel akademik efektiv PAE, sipas kategorive të mëposhtme: 1 (një) Profesor i Asociuar; 3 (tre) Lektor me titullin /Gradën shkencore Doc.Dr. 3 (tre) Lektor me gradën shkencore “Dr”. <u>Konstatohet se aktualisht personeli akademik i NJBKF është i ngarkuar dhe se ka pedagogë që zhvillojnë më shumë lëndë se sa lejon VKM 29, datë 10.09.2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të stafit akademik në IAL”.</u> <i>Evidenca III.4 CV e personelit akademik;</i> <i>Aneks Tabelat përmbledhëse, Tabela 4 Ngarkesa totale e personelit akademik të programit bachelor Kontabilitet Financë viti 2022-2023;</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.	Dokumentohet se Departamenti Kontabilitet Financë përgjegjës për programin e studimit zhvillon analiza vjetore si për mësimin edhe për punën kërkimore, pasi merret opinion i të gjithë personelit akademik sipas lëndëve / disiplineve. Në këtë analizë vjetore departamenti vlerëson përputhshmërinë e metodave të mësimdhënies me objektivat formues, të përcaktuar në dokumenta si: rregullore e Fakultetit Ekonomik, rregullore e NJBKF, rregullore e programit të studimit. Studentët janë të përfshirë në procesin e përmirësimit të metodave të mësimdhënies, përmes përgjigjeve të dhëna prej tyre në pyetësorët e shpërndarë nga NJSBC. Sugjerimet e tyre për më shumë lidhje të teorisë me praktikën Fakulteti e Departamenti i janë përgjigjur duke shtuar mundësitë për bashkëpunime me bizneset apo për zhvillimin e disa lëndëve apo temave në laboratorë. <i>Evidenca III.6 Pyetësor studentor;</i> <i>Evidenca III.7 Raport mbi rezultatet e pyetësorit studentor;</i>
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin	Nga dokumentat dhe vizita në UGJ rezulton se janë ngritur të gjitha strukturat për garantimin e cilësisë së mësimdhënies. Bazuar në Statutin e UGJ, njesitë ndihmëse në funksion të procesit mësimor – kërkimor janë:

e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	- Sektori i Standarteve të Cilësisë e Kurrikulave; - Sektori i Kërkimit Shkencor dhe marrëdhëniet me jashtë; UGJ ka të saktësuar në politikat e veta edhe trainimin e personelit akademik, si dhe sigurimin e kushteve për pjesmarrje në mobilitete në universitete të huaja në kuadër të programeve Erasmus+. UGJ ka revisitën shkencore “Kërkime universitare” në format letër dhe në format elektronik, e pajisur me ISSN, ku pasqyrohen botimet më të fundit të personelit akademik të UGJ. <i>Evidenca I.1 Statuti I UGJ, Neni 42;</i> <i>Evidenca I.25 Lista e mobiliteteve të UGJ;</i> <i>Evidenca I.24 Lista e projekteve të UGJ;</i> <i>Evidenca III.5 Udhëzues institucional mbi metodat innovative në mësimdhënie;</i> <i>Evidenca II.32 Përfshirja në trainime, mobilitete dhe projekte e stafit akademik të Fakultetit Ekonomik; Evidenca III.14 Periodikët e botuar në UGJ;</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> <i>Programi i studimit përmban forma të shumëllojshme të mësimdhënies dhe mësimxënies mbështetur në aktet rregullatore të institucionit dhe në funksion të arritjes së synimeve të programit.</i> <i>Personeli akademik është kompetent në shpjegimin e njourive, por konstatohet se aktualisht personeli akademik i NJBKF është i ngarkuar dhe se ka pedagogë që zhvillojnë më shumë lëndë se sa lejon VKM 29, datë 10.09.2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të stafit akademik në IAL”.</i> <i>Procesi mësimor është i fokusuar tek studenti për të lehtësuar mësimnxënien dhe karakterizohet nga praktikat më të mira.</i> <i>UGJ mbështet kualifikimin në drejtim të përmirësimit të kompetencave didaktike të stafit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Referuar RVB dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Institucioni, GVJ konstaton se IAL ka përcaktuar në dokumenta kriteret dhe mënyrat e testimit, vlerësimit të njohurive, dijeve e aftësive profesionale në dokumentat: • Rregullore e UGJ; • Rregullore e Njesisë Bazë Kontabilitet Financë; • Rregulloren e programit të studimit; Në programin e lëndës specifikohen edhe detyrimet e studentit për të shlyer lëndën si test i ndërmjetëm, provim përfundimtar, detyrë apo projekt kursi, të gjitha në shërbim të transmetimit të dijeve e njohurive tek studentët. Rregulloret janë të publikuara në faqen zyrtare të internetit: www.uogj.edu.al. Studentët gjejnë të gjitha informacionet e nevojshme rreth programit të studimit, në vecanti rreth kriterëve të vlerësimit të njohurive.. <i>Evidenca 4 RVB;</i> <i>Evidenca 4.1 Aneksat RVB;</i> <i>Evidenca 1.2 Rregullore e Universitetit Eqrem Cabej, Gjirokastrë, Nenet 68, 81,82,83;</i> <i>Evidenca 1.5 Rregullore e Fakultetit Ekonomik;</i> <i>Evidenca 1.9 Rregullore e Programit të studimit Bachelor Kontabilitet Financë, nenet 10, 11,12,13;</i>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Konstatohet se UGJ dhe Fakulteti Ekonomik kanë miratuar aktet nënligjore në zbatim të Ligjit 80/2015 Për Arsimin e Lartë e Kërkimin Shkencor në RSH”, lidhur me mënyrën e vlerësimit të studentëve të ciklit të parë. Më konkretisht, në rregulloren e programit të studimit, neni 11, 12,13, në rregulloren e Fakultetit Ekonomik, Kreu V, neni 26, dhe në rregulloren e zhvillimit të provimeve, neni 2. Nisur nga rregulloret, shihet se studentët informohen për mënyrën e vlerësimit të dijeve të tyre, përmes skemës së vlerësimit me pikë dhe të konvertuara në notë, konkretisht pikët totale ndahen në këtë mënyrë: në pjesmarrje e aktivizim në leksione e seminare, testi i ndërmjetëm, projekti apo detyra e kursit, provimi përfundimtar. Ky informacion i rëndësishëm u jepet studentëve qysh ditën e parë të nisjes së lëndës, apo në leksionin e parë, kur bëhet edhe prezantimi i programit të lëndës. <i>Evidenca 1.2 Rregullore e Universitetit Eqrem Cabej, Gjirokastrë;</i> <i>Evidenca 1.7 Rregullore e Njesisë bazë Kontabilitet Financë;</i>

	<i>Evidenca 1.9 Rregullore e Programit të studimit Bachelor Kontabilitet Financë;</i> <i>Evidenca 3.1.7 Rregullore për format e zhvillimit të provimeve;</i> <i>Evidenca II.28 Programet e lëndëve (syllabuset) të programit të studimit Bachelor Kontabilitet Financë 2022-2023;</i> <i>Evidenca 4 RVB; Evidenca 4.1 Anekset RVB;</i>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Sipas RVB e Rregulloreve të studimeve në UGJ, programeve të lëndëve, në programin e studimit, vlerësimi i studentëve bëhet përmes këtyre elementëve: provimi final dhe vlerësimi i vazhduar, ku përfshihen testi i ndërmjetëm dhe aktivizimi në seancat e seminareve. Totali i pikëve të fituara nga studenti në të gjithë këta elementë, mundëson vlerësimin e studentit me notë për lëndën përkatëse. Studentët e marrin informacionin për detyrimet e tyre në lëndë përveç se nga rregulloret edhe nga lektori ditën e parë të mësimit në atë lëndë. <i>Evidenca 1.4 Rregullore e studimeve UGJ;</i> <i>Evidenca II.28 Programet lëndore (syllabuset) e programit të studimit Bachelor Kontabilitet Financë;</i> <i>Evidenca 4 RVB; Evidenca 4.1 Anekset RVB;</i>
Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Sipas RVB dhe dokumentave të vëna në dispozicion nga institucioni, personeli akademik i Njesisë Bazë K-F, përmirëson metodat e mësimdhënies periodikisht, duke marrë edhe mendimin e studentëve. Këto mendime e sugjerime merren përmes pyetësorëve që shpërndan tek studentët NJSBC, për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, zbatimin e programit mësimor, metodat që përdoren nga pedagogu për të dhënë mësimin, për vlerësimin e studentit në testime apo në provim etj. <i>Evidenca III.6 Pyetësor studentor;</i> <i>Evidenca II.23 Informacion mbi analizën e përshtatshëmrisë së kurrikulave në UGJ;</i> <i>Evidenca III.7 Raport mbi rezultatet e pyetësorit studentor;</i> <i>Evidenca 4 RVB; Evidenca 4.1 Anekset RVB;</i>
Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e	Nga vizita në institucion dhe nga dokumentacioni konstatohet se UGJ krijon mundësi për përdorimin e metodave të larmishme të mësimdhënies, sipas rezultateve të pritëshme të të nxënit dhe objektivëve formues dhe kërkesat e tregut të punës për studentët e këtij program studimi. Duke përdorur infrastrukturë bashkëkohore për mësimdhënie, si laboratorë ku janë instaluar programe kompjuterike të specializuara, duke

pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	nxitur e krijuar mundësi për mobilitete të personelit akademik në institucione të arsimit të lartë jashtë vendit, përmes përdorimit të platformave on line për të zhvilluar mësimin, vecanërisht gjatë periudhës së pandemisë Covid – 19. Komunikimi me studentët qoftë në orët e mësimin, në orët e konsultimit, përmes email, krijon kushte për ecurinë më të mirë të studentëve, si gjatë përgatitjes së detyrave të lëna në klasë nga pedagogu edhe gjatë kohës së përgatitjes së tyre për provim. Lirshmëria në komunikim dhe krijimi i marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre dhe pedagogëve nxisin edhe ndjenjën e autonomisë tek studentit. <i>Evidenca III.2 Inventari i mjeteve didaktike, laboratorike e teknologjike;</i> <i>Evidenca I.25 Lista e mobiliteteve;</i> <i>Evidenca I.24 Lista e projekteve;</i> <i>Evidenca III.5 Udhëzues mbi zhvillimin e përdorimit të metodave innovative në mësimdhënie;</i> <i>Evidenca III.1.4 Manual i përdorimit të platformës Teams për stafin akademik;</i> <i>Evidenca III.9 Informacion për bibliotekë U-library, Fondi I librit;</i>
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> <i>Në rregulloren e institucionit, njësisë kryesore dhe të programit jepen sistemi i vlerësimit, format e vlerësimit dhe format e kontrollit të dijeve, dhe njihen nga studentët.</i> <i>Vlerësimi përfundimtar i studentit kryhet nëpërmjet vlerësimit gjatë semestrit, detyrave dhe projekteve të kursit si edhe vlerësimit gjatë testimeve të lëndës.</i> <i>Në fillim të çdo viti akademik studentët informohen për metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve.</i> <i>Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë process.</i> <i>Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksibel pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e tregut.</i>



Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Dokumentohet në Rregulloren e studimeve të UGJ, Kreu V, në Rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë, në Rregulloren e provimeve, neni 2, në syllabuset e lëndëve mënyra e testimit dhe vlerësimit të njohurive nga ana e studentëve të këtij programi studimi. Në syllabus përcaktohet se vlerësimi i lëndës bëhet duke grumbulluar pikët e provimi final, i cili vlerësohet 80% dhe vlerësimi i vazhduar, i cili ze 20%, ku përfshihen testi i ndërmjetëm dhe aktivizimi në seancat e seminareve. Informacioni për vlerësimin e lëndës u jepet studentëve në fillim të procesit mësimor nga pedagogu i lëndës. Në përfundim të procesit mësimor pedagogu u komunikon studentëve vlerësimin e vazhduar me pikë, dhe nëse u takon të futen në provimose jo, në varësi të frekuentimit të lëndës. Studentët kanë mundësi të hyjnë në provim për të marrë notë kaluese apo për përmirësim note tre herë: në sezonin e dimrit, në sezonin e verës dhe në sezonin e vjeshtës. Ndërsa, mundësitë për t'u diplomuar janë dy: në Korrik dhe në shtator. <i>Evidenca I.2 Rregullore e UGJ;</i> <i>Evidenca I.9 Rregullore e programit të studimit Bachelor Kontabilitet Financë;</i> <i>Evidenca III.12 Model i unifikuar i tezës së provimeve;</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Për të rritur transparencën dhe saktësinë në vlerësimin e studentëve Fakulteti Ekonomik përdor platformën Clean Score për korrigjimin e provimeve. Përgjigja e provimeve i vjen në kohë reale pedagogut, së bashku me analizë të rezultateve e kalueshmërisë. Kjo është mundësi e mirë për korrigjimin e provimeve që zhvillohen me alternativa, pasi siguron shpejtësi e saktësi në përgjigjet dhe vlerësimin e studentëve. Parashikohet në Rregulloren e programit të studimit, edhe forma të tjera testimi bazuar në llojin e lëndës si dhe munësisë së zhvillimit në laborator apo në auditor.

	Sipas RVB dhe dokumentave të programit të studimit, vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe rregulloret përkatëse ku mbështetet ky program. <i>Evidenca 4 RVB Bachelor KF UGJ;</i> <i>Evidenca I.2 Rregullore e UGJ;</i> <i>Evidenca I.9 Rregullore e programit të studimit Bachelor Kontabilitet Financë;</i> <i>Evidenca III.8 Marrëveshje bashkëpunimi AADF-UGJ;</i> <i>Evidenca III.1.7 RRegullore për format e zhvillimit të provimeve 2020-2021;</i> <i>Evidenca III.1.9 Format e zhvillimit të provimeve 2020-2021;</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Bazuar në RVB e dokumentat e institucionit konstatohet se vlerësimi përfundimtar i studentit përbëhet nga: vlerësimi i vazhduar prej 20 pikë apo 20% dhe provimit përfundimtar me 80 pikë apo 80%. Studentët informohen mbi vlerësimin e lëndës qysh në momentin që njihen me programin, syllabusin e lëndës, mbi intervalin e notave dhe të gjitha detyrimet e lëndës. <i>Evidenca 4 RVB Bachelor KF UGJ;</i> <i>Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në UGJ;</i> <i>Evidenca II.28 Programet e lëndëve të programit të studimit Bachelor;</i> <i>Evidenca III.12.1 Model i unifikuar i tezës së provimit;</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënies për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Bazuar në dokumenta dhe vizitën në institucion, studentit i krijohet mundësi të ketë vlerësim të plotë përmes disa elementeve, jo vetëm me provim, por edhe përmes testeve ndërmjetëse, punëve të laboratorit, detyrës apo projektit të kursit dhe provimit përfundimtar. Bazuar në rregulloren e provimeve, studentit i jepet mundësia të diskutojë në klasë rezultatet e provimit të parë, me qëllim që të përmirësojë rezultatet në provimin përfundimtar. Pas shpalljes së rezultateve, studentëve u jepet e drejta të rishikojnë tezat e korrigjuara prej komisionit të provimit, të ballafaquar edhe me zgjidhjen, për të parë vlerësimin që u është bërë. Marrin me këtë rast edhe komente e këshilla nga pedagogët e lëndës për të përmirësuar arritjet e tyre në provimin përfundimtar. Po kështu, edhe detyra e kursit si punë në grup dhe prezantim në klasë si grup i nxit studentët të përmirësojnë vlerësimin e tyre krahasuar me vlerësimin që kanë patur në provim. <i>Evidenca I.2 Rregullore e UGJ;</i> <i>Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në UGJ;</i>




	<i>Evidenca II.28 Programet e lëndëve të programit të studimit Bachelor;</i> <i>Evidenca III.10 Kodi i Etikës dhe vendimi për miratimin e Kodit të Etikës;</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Bazuar në rregulloren e provimeve, në rregulloren e Fakultetit Ekonomik, procesi i provimeve zhvillohet më të paktën dy vetë komision provimi, lektori dhe pedagogu i seminareve, për të shmangur plagjiaturën apo kopjimin. Po kështu, vendosja e një programi antiplagjiaturë në fakultet i mundëson pedagogëve të diktojnë nëse ka patur plagjiaturë në detyrat e kursit të dorëzuara për vlerësim. Studentët detyrohen të respektojnë Kodin e Etikës së UGJ, përfshirë edhe dispozitat e këtij kodi që parashikojnë sjelljen e tyre (moskopjimi, plagjiaturat e çdo forme etj). <i>Evidenca 1.2 Rregullore e UGJ;</i> <i>Evidenca 1.4 Rregullore e studimeve në UGJ;</i> <i>Evidenca III.10 Kodi i Etikës dhe vendimi për miratimin e Kodit të Etikës;</i>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Studentët e programit të studimit, vlerësohen në përputhje me arritjet e tyre në të gjithë elementët përbërës të vlerësimit, të parashikuara në rregulloren e Fakultetit, në rregulloren e programit të studimit, në rregulloren e provimeve si edhe në syllabusin e lëndës. Provimi i lëndës zhvillohet me sekretim. Sekretimi fletoreve është përgjegjësi përgjegjësit të departamentit. Sekretimi bëhet në prani të komisionit të provimit. Rezultatet jepen në kohën e duhur, sipas informimit që u është bërë studentëve për shpalljen e rezultateve. Në këto rregullore parashikohet e drejta e studentëve për të kërkuar rishikim të provimit, apo ballafaqim me rezultatet e provimeve, nëse nuk janë të bindur për vlerësimin. Në raste kur ka ankesa edhe pas ballafaqimit të rezultateve të provimeve nga ana e lektorit me studentët, ngrihet komision tjetër provimi nga ana e përgjegjësit të njesisë bazë për të rivlerësuar rezultatin, pas kërkesës së drejtuar nga studenti pranë sekretarisë mësimore, në zbatim të rregullores së Fakultetit Ekonomik. <i>Evidenca 1.2 Rregullore e UGJ;</i> <i>Evidenca 1.4 Rregullore e studimeve në UGJ;</i> <i>Evidenca 1.5 Rregullore e Fakulteti Ekonomik, neni 35, pika 6;</i> <i>Evidenca 1.7 Rregullore e Njesisë bazë Kontabilitet Financë, neni 31, pika 16;</i>
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e	

përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.				
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> <i>Testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet me anë të vlerësimit të vazhdueshëm përgjatë vitit.</i> <i>Institucioni ka vënë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat rrisin transparencën e vlerësimit. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</i> <i>Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Sipas RVB dhe dokumentave të institucionit konstatohet se Programi i studimit Bachelor Kontabilitet Financë është i organizuar në mënyrë që të garantojë marrjen e njohurive të konsoliduara në fushën e kontabilitetit e të financës, nga ana e studentëve të këtij program studimi, si nga pikpamja teorike ashtu edhe nga ajo praktike. Në përputhje me kuadrin e përgjithshëm të programit të studimit gjatë gjithë semestrave të studimit, studentët zhvillojnë lëndë bazë të detyrueshme, kombinuar me lëndët karakterizuese, dhe lëndë të tjera ndërdisiplinore dhe /ose integruese në një ose më shumë grupe disiplinash të ngjashme dhe/ose integruese me disiplinat karakterizuese, profile të programit dhe grup-lëndë me zgjedhje, ku i jepet rëndësi edhe lëndëve plotësuese. Në bazë të VKM nr 41, datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL", të ndryshuar, VKM nr.879 datë 18.12.2019, këta elemente grupohen në disa kategori:

	A. Lëndë bazë, që përcaktojnë formimin e përgjithshëm, përgatitjen metodologjike dhe kulturën e përgjithëshme në fushën e kontabilitetit, financës në total këto lëndë përfaqësojnë 36 kredite; B. B.Lëndë karakterizuese që lidhen me vecoritë e programit të studimit dhe japin një formim specifik në fushën e Kontabilitetit dhe Financës në total përfaqësojnë 98 kredite; C. Lëndë ndërdisiplinore dhe/ose integruese në një ose më shumë grupe disiplinash të ngjashme dhe / ose integruese me disiplinat karakterizuese, profile të programit dhe grup lëndë me zgjedhje të gjitha përfaqësojnë 23 kredite; D. Lëndë plotësuese, studentët fitojnë aftësi në gjuhë të huaja, aftësi informatike, aftësi komunikuese e prezantuese, aftësi për të lehtësuar hyrjen në tregun e punës, gjithsej 16 kredite; E. Detyrime përmbyllëse, që lidhen me përgatitjen e tezës së diplomës ose me provimin e përgjithshëm përfundimtar 7 kredite; <u>Në këtë program studimi, plani mësimor nuk parashikon praktikë mësimore si detyrim përmbyllës.</u> <i>Evidenca 4 RVB;</i> <i>Evidenca II.3 VKM nr 41, datë 24.01.2018;</i> <i>Evidenca II.3.1 VKM 879, datë 18.12.2019;</i> <i>Evidenca II.3.2 VKM nr 185 datë 25.03.2021;</i> <i>Evidenca II.1111 Plani mësimor Bachelor Kontabilitet Financë 2022-2023;</i> <i>Evidenca II.28 Programet e lëndëve (syllabuset) e programit të studimit Bachelor Kontabilitet Financë 2022-2023;</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	Sipas RVB e vizitës në institucion rezulton se Programi i studimit Bachelor në Kontabilitet Financë mundëson zhvillimin e aftësive të studentëve në fushën e Informatikës, të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit. Edhe përfshirja në planin mësimor e lëndëve të tilla si Gjuhë e huaj, ndihmon studentët për të shfrytëzuar literaturë në gjuhë të huaj gjatë zhvillimit të lëndëve, i mundëson edhe mobilitete në universitete jashtë vendit. Përfshirja e një lënde me zgjedhje “Shkrim e manaxhim Projektsh” zhvillon aftësitë e manaxhimit tek studentët, u mëson atyre si të bashkëveprojnë



	në grup, për zgjidhjen e detyrave dhe prezantimin e tyre në auditor. <i>Evidenca 4 RVB;</i> <i>Evidenca II.28 Programet e lëndëve (syllabuset) e programit të studimit Bachelor Kontabilitet Financë 2022-2023;</i> <i>Evidenca II.31 Vendim Senati Akademik për lëndën Shkrim dhe Manaxhim Projektsh;</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.	Sipas RVB dhe dokumentave të institucionit, Njesia Bazë Kontabilitet Financë është përgjegjëse për hartimin, shqyrtimin dhe përmirësimin e programeve të lëndëve, syllabuseve. Çdo vit diskutohen për ndryshime apo përmirësime të mundëshme dhe miratohen në mbledhjen e departamentit programet e lëndëve. Syllabusi përmban elementë të Kodit të Etikës, paraqet rezultatet e të nxënës të çdo disipline, qëllimet dhe objektivet e lëndës, përfitimet nga lënda në përfundim të saj, konceptet themelore të lëndës. Gjatë procesit mësimor, por vecanërisht në përfundim të lëndës lektori orienton studentët duke u ndalur tek çështjet më të rëndësishme të lëndës, duke i përgatitur për detyrimet përmbyllëse të lëndës. Pedagogët e lëndës caktojnë orare konsultimesh për studentët gjatë vitit, por edhe në fund para provimit përfundimtar. Komunikimi me studentët bëhet edhe përmes postës elektronike, për të shkëmbyer materiale, ushtrime, për t'iu përgjigjur pyetjeve të studentëve. Studentët marrin vlerësimin e tyre për kompetencat dhe aftësitë e fituara gjatë vitit, përmes rezultateve të arritura prej tyre në testin e ndërmjetëm, përmes vlerësimit të vazhduar dhe provimit përfundimtar. <i>Evidenca 4 RVB;</i> <i>Evidenca I.2 RRegullore e UGJ, neni 19, pika 2;</i> <i>Evidenca II.28 Programet e lëndëve (syllabuset) e programit të studimit Bachelor Kontabilitet Financë 2022-2023;</i> <i>Evidenca III.1.11 Zhvillimi i konsultimeve;</i>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	Personeli akademik i këtij programi studimi me kompetencat dhe arritjet në fushën akademike dhe kërkimore, është i aftë të zhvillojë punën në grup të studentëve, aftësitë e tyre për përgatitjen e punimeve e detyrave të kursit, duke demonstruar njohuritë që studentët marrin në leksione, seminare, laboratorë. Studentët kanë mundësi të përdorin bibliotekën qoftë atë fizike edhe atë digjitale në UGJ, për t'u përgatitur për detyrat e kursit,



Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	por jo vetëm, për t'u aftësuar për interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve të ndryshme të dhëna në klasë. Studentët kanë mundësi të përdorin edhe laboratorët për përgatitjen e detyrave, të punimeve të tyre kërkimore për pjesmarrje në konferenca studentore. Studentët mund të aplikojnë për mobilitete në universitete jashtë vendit në kuadrin e programeve me të cilat UGJ ka marrëveshje. <i>Evidenca 4 RVB;</i> <i>Evidenca I.25 Lista e mobiliteteve në UGJ;</i> <i>Evidenca II.15 Pjesmarrje në panairin Work and Study 2022;</i> <i>Evidenca II.28 Programet e lëndëve (syllabuset) e programit të studimit Bachelor Kontabilitet Financë 2022-2023;</i> <i>Evidenca II.32 Përfshirja në trainime mobilitete dhe projekte të stafit akademik të FE;</i> <i>Evidenca III.9 Informacion për bibliotekën U-library, Fondi i librit;</i>
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Në bazë të RVB dhe dokumentacionit vënë në dispozicion, personeli akademik efektiv dhe ai me kontratë zhvillojnë orë leksioni dhe seminari të hapura, për çështje të ndryshme lidhur me të reja të shkencës, teknologjisë brenda apo jashtë strukturës së programit të studimit. <i>Evidenca 4 RVB;</i> <i>Evidenca III.15 Plani I veprimtarive akademike kërkimore shkencore të UGJ 2019-2020;</i> <i>Evidenca III.15.1 Plani I veprimtarive akademike kërkimore shkencore të UGJ 2021-2022;</i> <i>Evidenca III.15.2 Plani I veprimtarive akademike kërkimore shkencore të UGJ 2022-2023;</i> <i>Evidenca II.32 Përfshirja në trainime mobilitete dhe projekte të stafit akademik të FE;</i>
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> <i>Programi i studimit garanton thellimin e njohurive, dhe zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve. <u>Një nga detyrimet përmbyllëse sic është praktika profesionale nuk përfshihet në planin mësimor.</u></i> <i>Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit</i>

	<i>Institucioni krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.	Në bazë të RVB dhe rregulloreve të institucionit, si dhe vizitës në institucion rezulton se detyrimet përmbyllëse të programit të studimit janë mbrojtja e punimit të diplomës apo e provimit përfundimtar. Këto detyrime përcaktohen në nenet 59-64 të Rregullores së studimeve në UGJ dhe shtojcave të kësaj rregulloreje sic është Manuali i punimit të diplomës, apo në nenin 93 të Rregullores së UGJ. Studenti bën kërkesë për pedagogun udhëheqës të diplomës dhe departamenti përcakton pedagogun udhëheqës për çdo student. Në këto rregullore përcaktohet pragu i notës mesatare që duhet të ketë student që përgatit tema diplome, apo që duhet të bëjë provim të përgjithshëm përfundimtar. NJBKF-Departamenti miraton edhe programin e provimit të përgjithshëm. <i>Evidenca 4 RVB;</i> <i>Evidenca I.2 Rregullore e UGJ;</i> <i>Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në UGJ;</i> <i>Evidenca I.5 Rregullore e Fakultetit Ekonomik;</i> <i>Evidenca I.9 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor Kontabilitet Financë 2022-2023;</i> <i>Evidenca III.11.2 Manuali i punimit të Diplomës;</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e	Sipas dokumentacionit vënë në dispozicion prej institucionit, qysh në nisje të programit të studimit, studentët informohen prej strukturave përgjegjëse për të drejtat dhe detyrimet e tyre, prej të cilave shumë të rëndësishme janë detyrimet përmbyllëse si: tema e diplomës apo provimi i përgjithshëm përfundimtar. Njesia Bazë Kontabilitet Financë u siguron studentëve

Im *Le.*

nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	informacione, udhëzime, materiale të nevojshme në funksion të plotësimit të këtyre detyrimeve përmbyllëse. <i>Evidenca 4 RVB;</i> <i>Evidenca I.2 Rregullore e UGJ;</i> <i>Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në UGJ;</i> <i>Evidenca I.5 Rregullore e Fakultetit Ekonomik;</i> <i>Evidenca I.9 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor Kontabilitet Financë 2022-2023;</i> <i>Evidenca III.11.2 Manuali i punimit të Diplomës;</i> <i>Evidenca III.11 Program i provimit të përgjithshëm përfundimtar në Kontabilitet Financë;</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Në bazë të RVB e rregulloreve të institucionit, konstatohet se provimi i përgjithshëm zhvillohet në prani të komisionit të provimit, i cili përbëhet nga personel akademik i departamentit, nga fusha që mbulon program i provimit të përgjithshëm përfundimtar. Komisioni i provimit propozohet nga përgjegjësi i NJBKF dhe miratohet nga Dekani i FE. Programi i provimit të përgjithshëm përfundimtar hartohet duke përmbledhur të gjitha lëndët që janë zhvilluar në këtë program, studimi, sipas peshës e rëndësisë së këtyre lëndëve, të cilat janë të kategorizuara ndërmjet lëndëve bazë, lëndëve karakterizuese, lëndëve ndërdisiplinore dhe lëndëve plotësuese, nga fusha e kontabilitetit dhe e financës. Përmes provimit të përgjithshëm synohet të kontrollohen e të vlerësohen njohuritë dhe kompetencat e fituara nga ana e studentëve gjatë viteve të ndjekes së këtij programi studimi. <i>Evidenca 4 RVB;</i> <i>Evidenca I.2 Rregullore e UGJ;</i> <i>Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në UGJ;</i> <i>Evidenca I.5 Rregullore e Fakultetit Ekonomik;</i> <i>Evidenca I.9 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor Kontabilitet Financë 2022-2023;</i> <i>Evidenca III.11 Program i provimit të përgjithshëm përfundimtar në Kontabilitet Financë;</i>
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në	Sipas RVB, rregulloreve, vizitës në institucion konstatohet se çdo student, i cili plotëson kriteret për të përmbyllur detyrimet e tij përmes punimit të diplomës, udhëhiqet nga një pedagog i njesisë bazë Kontabilitet Financë. Së bashku, me pedagogun

përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	udhëheqës përcaktojnë strukturën e punimit, mbledhjen e të dhënave, përpunimin e të dhënave, analizën e tyre, deri tek konkluzionet e punimit. Në çdo hap të punimit të diplomës, studenti komunikon me pedagogun dhe duhet të marrë miratimin e pedagogut udhëheqës nëse punimi i diplomës është i plotë dhe përmbush kriteret për t'u paraqitur para komisionit për mbrojtje. Pedagogu duhet të firmosë punimin dhe duhet të bëjë vlerësimin me shkrim të tij, duke plotësuar një formular tip të miratuar nga Fakulteti, referuar Manualit të punimit të Diplomës. <i>Evidenca 4 RVB;</i> <i>Evidenca I.2 Rregullore e UGJ;</i> <i>Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në UGJ;</i> <i>Evidenca I.5 Rregullore e Fakultetit Ekonomik;</i> <i>Evidenca I.9 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor Kontabilitet Financë 2022-2023;</i> <i>Evidenca III.11.2 Manuali i punimit të Diplomës;</i> <i>Evidenca III.11 Program i provimit të përgjithshëm përfundimtar në Kontabilitet Financë;</i>
Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Njesia Bazë Kontabilitet Financë e Fakultetit Ekonomik, krijon mundësi për studentët të përdorin mjediset e fakultetit për të përgatitur punimin e diplomës, për të përdorur laboratorët, përmes bibliotekës online etj. Studentët mbështeten nga pedagogët e tyre udhëheqës gjatë përgatitjes së punimit të diplomës. <i>Evidenca 4 RVB;</i> <i>Evidenca III.2 Inventari i mjeteve didaktike, laboratorike dhe teknologjike;</i>
Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Pasi përfundon provimi i përgjithshëm final apo diploma, studenti vlerësohet me notë nga komisioni. Nota u komunikohet studentëve nga komisioni, nota pasqyrohet në procesverbal, i cili firmoset nga të gjithë anëtarët e komisionit. <i>Evidenca 4 RVB;</i> <i>Evidenca I.2 Rregullore e UGJ;</i> <i>Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në UGJ;</i> <i>Evidenca I.5 Rregullore e Fakultetit Ekonomik;</i>

	<i>Evidenca I.9 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor Kontabilitet Financë 2022-2023;</i> <i>Evidenca III.11.2 Manuali i punimit të Diplomës;</i> <i>Evidenca III.11 Program i provimit të përgjithshëm përfundimtar në Kontabilitet Financë;</i>
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	UGJ sipas rregulloreve të miratuara në zbatim të Ligjit 80/2015, në përfundim të studimeve i pajis studentët me diplomën dhe suplementin e saj, të miratuara nga MAS. Në mënyrë specifike për këtë shprehet rregullore e Sekretarisë Mësimore e Fakultetit Ekonomik, neni 4. Studenti njoftohet të tërheqë diplomën dhe me kërkesë të studentit përgatitet edhe suplementi i diplomës, në përfundim të studimeve. <i>Evidenca 4 RVB;</i> <i>Evidenca I.2 Rregullore e UGJ;</i> <i>Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në UGJ;</i> <i>Evidenca I.5 Rregullore e Fakultetit Ekonomik;</i> <i>Evidenca I.9 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor Kontabilitet Financë 2022-2023;</i> <i>Evidenca II.6 Udhëzim Nr.11, datë 02.04.2020 i MASR "Për përcaktimin e përmbajtjes dhe formës së Suplementit të Diplomës";</i> <i>Evidenca II.6.1 Format Suplementi i Diplomës; Evidenca III.13 Rregullore e Sekretarisë;</i>
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	UGJ e ka të detyrueshme të ruajë e të arkivojë sipas një afati të caktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet informacione për studentët nëse kërkohet. UGJ në përputhje me nenin 101 të Ligjit për Arsimin e Lartë nr 80/2015, Statutin e UGJ, neni 44 dhe rregulloren e sekretarisë, administron këto dokumenta: Regjistrin themeltar të studentëve; Regjistrin e arritjeve akademike; Regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave. <i>Evidenca 4 RVB;</i> <i>Evidenca I.2 Rregullore e UGJ;</i> <i>Evidenca I.1 Statuti I UGJ; Evidenca III.13 Rregullore e Sekretarisë;</i>
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i>

	<i>Kuadri rregullator i UGJ parashikon në mënyrë të detajuar procedurat që ndiqen për përgatitjen për detyrimet përmbyllëse të programit të studimit.</i> <i>Personeli akademik orienon dhe ndihmon studentët në procesin e përgatitjes së detyrimeve përmbyllëse.</i> <i>Në përfundim të ciklit të studimeve, studenti vlerësohet me notë dhe pajiset me diplomën dhe suplementin e saj.</i> <i>Pranë UGJ dokumentacioni i studentit ruhet në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në	Nga analiza e informacionit të paraqitur në RVB dhe dokumentacionit shoqërues, GVJ konstatoi se stafi i angazhuar në programin e studimit “Bachelor në Financë Kontabilitet”, mbulon një numër të lartë lëndësh, duke rezultuar në një ngarkesë të madhe mësimore. Lëndët që stafi mbulon, i përkasin jo vetëm fushës së finances dhe kontabilitetit, por dhe fushës së ekonomikut, manaxhimit dhe marketingut. Kjo gjë mund të rezultojë në përmbushjen e standardit cilësor të mësimdhënies. Edhe numri i lëndëve që mbulon një pedagog arrin <i>deri në 8. Madje ngarkesa mësimore e një pedagogu tejkalon dhe atë të përcaktuar me ligj, pavarësisht se gjatë vizitës dhe takimeve me stafin u evidentua mungesa e</i>

përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

kapacitetit të institucionit për të paguar orët suplementare. Kjo gjë vë në dyshim cilësinë dhe eficiencën e mësimdhënies.

Nga shyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, janë angazhuar staf akademik për tre vite akademike si më poshtë vijon:

Tituj/grada	2020 - 2021		2021 - 2022		2022 - 2023	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr	-	-	-	-	-	-
Prof.As.Dr	-	-	-	-	1	-
Dr/PhD	3	-	3	-	3	-
Doc. Dr	4	-	4	-	3	-
Msc	-	7	-	4	-	4
Në total	7	7	7	4	7	4

Meqënëse nga dokumentacioni dhe gjatë vizitës në IAL, GVJ vlerësoi parregullsi të CV-ve, ai kërkoi rregullimin dhe përmirësimin e tyre dhe të ngarkoheshin sërish në portalin e ASCAL.

Nga verifikimi i të dhënave statistikore, (tabelat 12-12.2) ngarkesa mësimore është mbajtur nga personeli akademik efektiv, sipas të dhënave më poshtë:

Viti akademik	% e ngarkesës mësimore e realizuar nga PAE
2020-2021	85 %
2021-2022	90 %
2022-2023	90 %

Evidenca 4.1 Aneksë RVB: Tab.1; Tab 6.1., 6.2 dhe 6.3, tab 12-12.2;

Evidenca III.4: CV e shkurtuara të personelit akademik; Evidenca 1.13.3: Raporti i veprimtarisë kërkimore shkencore 2021- 2022;

Evidenca 1.13.2: Raporti i veprimtarisë kërkimore shkencore 2020- 2021;

Evidenca 1.13.1: Raporti i veprimtarisë kërkimore shkencore 2019- 2020;

Evidenca 1.29: Tabela përmbledhëse e personelit akademik;

Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Nga analiza e informacionit të paraqitur në RVB dhe dokumentacionit shoqërues, GVJ konstatoi një qëndrueshmëri të stafit të këtij program studimi, si dhe plotësim të kriterëve ligjore për ta. <i>Evidenca 1.29: Tabela përmbledhëse e personelit akademik;</i>
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriterë të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	<i>Gjatë takimeve të zhvilluara në institucion, GVJ konstatoi se përveç mungesës së fondit për shtim të organikës, UGJ ndeshte dhe me vështirësinë për të punësuar staf të kualifikuar që plotëson kërkesat ligjore për këtë program studimi.</i> Pavarësisht kësaj, GVJ vlerëson shumë përpjekjet individuale të stafit aktual për t'u pajisur me tituj dhe grada. Procedurat e rekrutimit dhe vlerësimit të personelit akademik parashikohen në Statutin e UGJ-së. <i>Evidenca 1.1: Statuti UGJ;</i>
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqërues, si dhe në takimet gjatë vizitës në UGJ, GVJ konstatoi se angazhimi i personelit ndihmës në këtë institucion ishte në nivelet minimale për shkak edhe të numrit të kufizuar të studentëve.
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në	Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, përmes Degës së Burimeve njërëzore. Kjo zyrë është përgjegjëse për të ruajtur të gjithë dokumentacionin procedural lidhur me stafin që angazhohet në fakultet, ruajtjen dhe

programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtar në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	përditësimin në çdo vit akademik të të dhënave të personelit efektiv dhe atij me kontratë Gjatë takimit me përfaqësuesen e kësaj zyre, GVJ konstatoi se kjo zyrë plotëson, ruan dhe përditëson të dhënat mbi anëtarët e personelit akademik të angazhuar në programet e studimit që ofron UGJ në formën e dosjeve personale të personelit. Në mënyrë rastësore, GVJ shqyrtoi dosjen personale të dy pedagogëve të programit të studimit (një me kohë të plotë dhe një me kontratë) dhe konstatoi se dosja ishte e plotësuar me dokumentet e nevojshëm si: CV, kontrata e punës, diplomat dhe kualifikimet, librezat shëndetësore etj. Kjo zyrë ka ndjekur procedurat për rekrutimin e personelit, ku kriteret i përcakton njësia bazë përkatëse, në vijim priteshin aplikimet, kontrolloheshin nga personeli përgjegjës, dhe procedoheshin për intervistim. <i>Evidenca 1.1 Statuti i UGJ, kreu VI;</i> <i>Evidenca 1.29: Tabela përmbledhëse e personelit akademik;</i> <i>Evidenca III.4: CV e shkurtuara të personelit akademik;</i> <i>Evidenca: CV në europass;</i> <i>Evidenca shtesë: Ngarkesa mësimore e stafit akademik;</i>
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqërues, si dhe në takimet gjatë vizitës në UGJ, GVJ konstatoi lidhjen e disa marrëveshjeve të bashkëpunimit në nivel institucioni me përfaqësues të institucioneve publike dhe organizata, të cilat mundësojnë edhe realizimin e praktikave profesionale të studentëve të këtij programi studimi. Por në kuadër të bashkëpunimit me institucionet private dhe bizneset, marrëveshjet ishin të pakta. <i>Evidenca 1.23: Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit;</i>
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në	Gjatë takimit me studentët e këtij programi studimi, ata konfirmuan se institucioni u kishte ofruar mbështetje për

realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	gjetjen e vendit të punës, megjithëse shumica e kishte gjetur vetë, pasi ishin të punësuar që gjatë viteve të studimit. <i>Evidenca I.23: Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit;</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> <i>Personeli akademik që angazhohet në këtë program studimi ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për mësimdhënien në programin e studimit Bachelor, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi.</i> <i>Qëndrueshmëria e personeli akademik është e konsiderueshme.</i> <i>Dega e Burimeve Njerëzore të UGJ mbledh, ruan dhe përditëson të dhënat e personelit akademik të angazhuar me kohë të plotë dhe me kontratë.</i> <i>UGJ ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi për realizimin e praktikave profesionale, por duhet të shtojë marrëdhëniet me biznesin.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën	Referuar RVB, vizitës në institucion dhe të dhënave në portalin e ASCAL për infrastrukturën e UGJ dhe Fakultetit të Ekonomisë, GVJ konstaton se institucioni disponon salla leksionesh dhe auditorë për seminare. Universiteti zhvillon mësim në tre godina, të cilat plotësojnë kushtet higjieno sanitare dhe të sigurisë, pjesa më e madhe auditoreve dhe zyrave kanë ngrohje qendrore ose të personalizuar me kondicionere.

specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	<i>Evidenca IV.9: Infrastruktura UGJ;</i> <i>Evidenca IV.11: Çertifikatë për sigurinë nga zjarri;</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	GVJ vizitoi disa salla leksionesh dhe seminaresh, bibliotekën dhe mjedise të tjera në përdorim të përbashkët dhe vuri re që mjediset, sipas funksionit të tyre, ishin të pajisura edhe me kompjutera, projektorë dhe lidhje interneti, si dhe kishin ndriçim dhe ajrosje optimale për kryerjen e aktivitetit mësimor. Në takimet me personelin akademik dhe studentët e këtij programi studimi, gjatë vizitës në institucion, GVJ konfirmoi se ambientet ku zhvillohet mësimi, plotësojnë normativën e sipërfaqes së shfrytëzueshme sipas kuadrit rregullator në fuqi. <i>Evidenca IV.9: Infrastruktura UGJ;</i> <i>Evidenca IV.11: Çertifikatë për sigurinë nga zjarri;</i>
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Nga shqyrtimi i planit mësimor, GVJ konstaton se programi i studimit “Bachelor në Kontabilitet -Financë” nuk ka parashikuar orë laboratorike. <i>Evidenca 4 RVB;</i> <i>Evidenca II.28 Programet e lëndëve (syllabuset) e programit të studimit Bachelor Kontabilitet Financë 2022-2023;</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Në funksion të programeve të studimit të Fakultetit të Ekonomisë, Institucioni është në gjendje të garantojë kapacitete infrastrukturore për të kryer veprimtaritë praktike lidhur me programin. <i>Evidenca IV.9: Infrastruktura UGJ;</i>
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i>

	UGJ ka ambiente të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarive mësimore. Klasat e leksioneve dhe të seminareve dhe ambientet e tjera janë të pajisura me infrastrukturën dhe teknologjinë e nevojshme për një proces mësimor bashkëkohor.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Bazuar në programet e lëndëve, GVJ konstatoi se titujt e përfshirë në literaturën bazë dhe ndihmëse të programit të studimit “Bachelor në Kontabilitet-Financë” janë shumë të vjetër, dhe nga institucioni nuk bëhet përditësim i literaturës, kjo edhe për shkak të mungesës së fondeve. <i>GVJ rekomandon që institucioni duhet të punojë në drejtim të marrëveshjeve të rëndësishme dhe nxitjes së stafit në përfshirjen nëpër projekte, që do të mundësojnë edhe këtë aspekt të rëndësishëm të rritjes së efikasitetit të mësimdhënies dhe mësimnxënies.</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	<i>Evidenca II.28.2 Programet lëndore të PS;</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Gjatë vizitës në institucion, GVJ bëri një takim me punonjësit e bibliotekës së UGJ në ambientet e saj. Biblioteka ndodhej në godinën C, me 3 salla leximi, mundësi aksesit përmes kompjuterave të vendosura në të në internet dhe në bibliotekat online, më specifikisht Jstore të mundësuar nga AADF dhe me një kohë shërbimi deri pasdite për studentët.
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste	Gjatë vizitës në institucion u vu re sasia e kufizuar e titujve të librave në funksion të këtij program studimi.

mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Në faqen zyrtare të UGJ: https://www.uogj.edu.al/biblioteka-online. stafi akademik dhe studentët mund të aksesojnë online, shërbim i cili ofrohet falas. <i>Evidenca III.9: Fondi i librit; U library;</i> <i>Evidenca III.9.1 JSTOR;</i> <i>Evidenca IV.14.1: Biblioteka, Manuali i përdorimit;</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Ndërkohë, UGJ ka krijuar mundësi për studentët për akses për bibliotekat online, si Jstore dhe U library. Gjithashtu, fizikisht biblioteka qëndron hapur çdo ditë të javës, nga e hëna deri të premte, në intervalin 08.00-19.00. <i>Evidenca III.9: Fondi i librit; U library;</i> <i>Evidenca III.9.1 JSTOR;</i> <i>Evidenca IV.14.1: Biblioteka, Manuali i përdorimit;</i>
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Gjatë vizitës në ambientet e bibliotekës, GVJ konstatoi se biblioteka është e pajisur me vende pune me kompjuter, që mund të përdoren nga studentët për t'u lidhur me platformat e bibliotekave elektronike për të hulumtuar në funksion të realizimit të projekteve, detyrave të kursit dhe temës së diplomës. Shërbimi i bibliotekës ofrohet nga e hëna deri të premte, në intervalin 08.00-19.00, në përputhje me nevojat e studentëve të këtij programi studimi por edhe të studentëve të programeve të tjera. <i>Evidenca IV.14.2: Rregullore e bibliotekës;</i>
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqërues, si dhe në takimet gjatë vizitës në UGJ, GVJ vlerëson se institucioni duhet të angazhohet në mënyrë më aktive lidhur me cilësinë e fondit fizik të bibliotekës,

fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	përditësimin dhe shkallën e shfrytëzimit të saj. Duhet punuar më shumë përmes marrëveshjeve të mundshme dhe projekteve.			
Konkluzione	GVJ konstaton një vjetërsim të literaturës dhe rekomandon përditësimin e saj, duke forcuar marrëveshjet ekzistuese dhe lidhjen e marrëveshjeve të reja, si dhe mundësinë përmes projekteve (meqënëse buxheti është shumë i limituar) për përmbushjen e këtij standardi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Institucioni disponon një sërë rregulloresh dhe procedurash të cilat rregullojnë menaxhimin e informacionit që lidhet me studentin. Sipas Ligjit 80/2015 të Arsimit të Lartë, Statutit të UGJ; Rregullores së Sekretarisë Mësimore, menaxhohet i gjithë informacioni që lidhet me studentët, nga regjistrimi deri në diplomim. Gjatë vizitës në institucion, GVJ verifikoi mbajtjen e regjistrave manual nga sekretaria mësimore në lidhje me studentët e programit. Gjatë vizitës në sekretari, GVJ verifikoi




	me zgjedhje dosjen e plotë të dy studentëve të programit të studimit “Bachelor në Kontabilitet-Financë” dhe përdorimin e regjistrave përkatës (themeltar, të arritjeve akademike & të lëshimit të diplomave) sipas kërkesave të kuadrit ligjor në fuqi. <i>Evidenca I.1: Statuti i UGJ;</i> <i>Evidenca III.13: Rregullore e sekretarisë mësimore; Evidenca IV.15: Rregullore e programit të dixhitalizimit të sistemit universitar Esse3;</i>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Informacioni, dokumentacioni dhe aktiviteti i personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit, manaxhohet nga zyra e burimeve njerëzore në formë manual dhe elektronike.
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Në dokumentacionin e vënë në dispozicion rezulton dhe përdorimi i sistemit të Pitagorës, por <i>IAL duhet të përshtasë rregulloren për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit në edukim me këtë sistem të ri Pitagora.</i> <i>Evidenca IV.15: Rregullore e programit të dixhitalizimit të sistemit universitar Esse3;</i>
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Në përgjithësi, nga vizita në institucion, u konstatua se komunikimi me studentët i pedagogëve realizohet përkës email-eve dhe platformës Teams. Gjithashtu, nëpërmjet projektit Erasmus Capacity Building, në të cilin UGJ është i përfshirë, po pilotohet një platformë Learning Management System “Learning Key”, në kuadër të ngritjes së kapaciteteve të stafit akademik dhe studentëve dhe përmirësimit të vijueshëm të cilësisë së procesit akademik. <i>Evidenca III.1: Urdhër për përdorimin e platformës “Learning Key”;</i>
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e	Sistemi aktual i menaxhimit të informacionit nuk siguron në kohë reale bashkërendimin e zyrave, stafit dhe studentëve, por

administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	nisur nga numri i ulët i studentëve, ky system funksionon të paktën në periudhë afatshkurtër.			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Informacioni që lidhet me UGJ, strukturimin e tij, programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet që lidhen me procesin mësimor, është në gjuhën shqipe. Në gjuhën angleze rezulton i publikuar vetëm një pjesë e informacionit.			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson që UGJ-FE disponon një sistem të brendshëm të manaxhimit i cili është relativisht i mjaftueshëm për bashkërendimin e hallkave të institucionit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në UGJ, <u>GVJ konstatoi se institucioni nuk harton raporte financiare të kostove sipas njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit</u>, por harton një raport financiar në nivel universiteti. Projekt buxheti hartohet nga Administratori i institucionit mbi propozimet e njësisë kryesore dhe të njësisë bazë, në mbështetje të planit strategjik të zhvillimit të institucionit dhe planin buxhetor afatmesëm të tij. Këto dokumenta më pas miratohen nga Bordi i Administrimit të UGJ, që mbikëqyr edhe zbatimin e tyre. <i>Evidenca 4. RVB;</i> <i>Evidenca 1: Statuti UGJ;</i>

	<i>Evidenca I.3: Strategjia e Zhvillimit të UGJ për periudhën 2020-2025;</i> <i>Evidenca IV.16: Propozim Buxheti;</i> <i>Evidenca IV.16.4: Projekt buxheti për vitin 2023;</i>
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	GVJ konstaton se hartohet raporti vjetor financiar, në bazë të planeve të dorëzuara nga njësitë bazë për programet e studimit që ato mbulojnë, dhe bëhet një parashikim të të ardhurave dhe shpenzimeve të parashikuara për vitin akademik pasardhës (projekt buxheti). Në këto raporte financiare të ardhurat janë të klasifikuara sipas burimeve kryesore të financimit të UGJ (buxheti i shtetit, tarifat e shkollimit, tarifat e regjistrimit, të ardhura nga shërbime të ndryshme të kryera, donacione e burime të tjera etj). Gjithashtu, shpenzimet janë të klasifikuara sipas natyrës së tyre: në shpenzime për personelin, shpenzime operative, shpenzime për infrastrukturën, sigurimin e cilësisë etj. <i>Evidenca 4. RVB;</i> <i>Evidenca 1: Statuti UGJ;</i> <i>Evidenca I.3: Strategjia e Zhvillimit të UGJ për periudhën 2020-2025;</i> <i>Evidenca IV.16: Propozim Buxheti;</i> <i>Evidenca IV.16.4: Projekt buxheti për vitin 2023;</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Referuar RVB-së konstatohet se institucioni kryen në mënyrë periodike auditime nga KLSH si çdo institucion tjetër publik, si dhe nga Drejtoria e Auditimit të ministrisë së linjës (MAS). <i>Evidenca IV.16.1 deri 3 Raportet financiare vjetore (2020, 2021, 2022);</i> <i>Evidenca IV.17 Raporti Përfundimtar i KLSH;</i> <i>Evidenca IV.17.1 dhe 2 Raportet e Auditimit MAS (2018 dhe 2022);</i>
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit	Raportimi mbi buxhetin bëhet në nivel Senati Akademik dhe Bordi Administrimi, ku njësia kryesore ka përfaqësuesit e saj. Për të gjithë mënyrën si procedohet në hartimin e projekt-buxhetit dhe miratimin e tij, si dhe në raportimet vjetore

të miratuar të vitit paraardhës.	financiare brenda universiteteve publike, raportimi nuk ka shkuar ende në nivel njësie bazë. <i>Evidenca 4. RVB;</i> <i>Evidenca IV.16.1 deri 3 Raportet financiare vjetore (2020, 2021, 2022;</i>			
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	Duke qenë IAL publike, dhe në bazë të RVB-së, UGJ garanton qëndrueshmëri financiare, por nisur nga vështirësitë e pagesës së mbingarkesës së stafit, apo vështirësive të tjera të përmendura më lart, <u>UGJ duhet të intensifikojë përpjekjet për sigurimin e burimeve të tjera, si për shembull projekte të ndryshme.</u> <i>Evidenca 4. RVB;</i> <i>Evidenca IV.16.1 deri 3 Raportet financiare vjetore (2020, 2021, 2022;</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se UGJ garanton qëndrueshmëri financiare, por nisur nga vështirësitë e pagesës së mbingarkesës së stafit, apo vështirësive të tjera të përmendura, UGJ duhet të intensifikojë përpjekjet për sigurimin e burimeve të tjera, si për shembull projekte të ndryshme.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1




Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në dokumentacionin shoqërues dhe në informacionin e marrë gjatë vizitës në institucion, GVJ konkludon se politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin akademik të studentëve të programit të studimit “Bachelor në Kontabilitet-Financë” janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi dhe Statutin e UGJ. Rregullorja e njësisë kryesore, rregullorja e njësië bazë dhe rregullorja e programit të studimit parashikojnë qartë kriteret dhe procedurat e përgjithshme të pranimit të studentëve në programet e ciklit të parë, si dhe procedurat lidhur me ecurinë deri në diplomim, përfshirë vlerësimin e dijeve dhe mundësinë e transferimit në programe të tjera.
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Statuti dhe Rregullorja e UGJ garantojnë barazinë e të drejtave për kandidatët dhe studentët e programit të studimit, bazuar në meritat personale, respektimin e të drejtave dhe lirive themelore dhe përjashtimin e çdo lloj diskriminimi (përkatësisht neni 3). <i>Evidenca 1.1: Statuti i UGJ;</i> <i>Evidenca 1.2: Rregullore e UGJ;</i> <i>Evidenca 1.6: Rregullore e NJBKF;</i> <i>Evidenca 1.9: Rregullore e programit të studimit Bachelor në Kontabilitet Financë;</i>
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	Në Statutin dhe në rregulloret e UGJ, parashikohen kriteret dhe procedurat e përgjithshme të pranimit të studentëve në programet e ciklit të parë, si dhe procedurat lidhur me ecurinë deri në diplomim, përfshirë vlerësimin e dijeve dhe mundësinë e transferimit në/nga programe të tjera. Sipas parashikimeve në këto rregullore, për çdo vit akademik Departamenti i Kontabilitet dhe Financës propozon kriteret e përzgjedhjes në programin e studimit “Bachelor në Kontabilitet Financë”, të cilat më pas miratohen nga Senati Akademik i UGJ. Aktualisht, pranimi në këtë program studimi është i mundur për studentët që vërtetojnë me dokument zyrtar (diplomë) përfundimin e shkollës së mesme publike ose jo publike, brenda ose jashtë vendit të njohur nga MAS, për studentët që vërtetojnë me dokumente zyrtare transferimin nga IAL të tjera, si dhe që pranojnë të paguajnë tarifën e studimeve.




Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Kriteret dhe kuotat e pranimit të studentëve, pas marrjes së miratimit sipas kuadrit rregullator, bëhen publike nga UGJ përpara fillimit të aplikimeve për pranimet në ciklin e parë të studimeve, përmes publikimeve në faqen zyrtare web të institucionit.
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Në bazë të dokumentacionit në dosjen e vlerësimit të brendshëm, në bazë të statutit të UGJ dhe rregulloreve përkatëse, përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Në bazë të dokumentacionit në dosjen e vlerësimit të brendshëm, në bazë të statutit të UGJ dhe rregulloreve përkatëse, rezulton se në lidhje me kandidatët me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara, si dhe kandidatëve nga shtete të tjera, vendimi për kuotat e pranimit të tyre merret në përputhje me rregulloret e institucionit në senat, pas propozimeve që vijnë nga fakultetet/departamentet.
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	<i>Evidenca 1.1: Statuti i UGJ;</i> <i>Evidenca 1.2: Rregullore e UGJ;</i> <i>Evidenca 1.6: Rregullore e NJBKF;</i> <i>Evidenca 1.9: Rregullore e programit të studimit Bachelor në Kontabilitet Financë;</i> <i>Evidenca V.2: Kuotat e pranimit;</i> <i>Evidenca V.2.1 dhe 2: Kriteret e pranimit;</i> <i>Evidenca V.2.3: Vendim senati për miratimin e kriterëve dhe kuotave 2024-2025;</i>
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi	Në përputhje me rregulloren e UGJ dhe në respekt të aspekteve ligjore dhe administrative, Bordi Administrimit merr vendime në lidhje me ndihmën/mbështetjen e studentëve në ciklin bachelor dhe master.



për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	<i>Evidenca II.14. Vendimi i Bordit të administrimit për bursat dhe kategoritë e veçanta;</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> <i>Në rregulloret e UGJ parashikohen kriteret dhe procedurat e përgjithshme të pranimit të studentëve në programet e ciklit të parë, si dhe procedurat lidhur me ecurinë deri në diplomim, përfshirë vlerësimin e dijeve dhe mundësinë e transferimit në/nga programe të tjera.</i> <i>UGJ bën publike kriteret dhe kuotat e pranimit të studentëve, përpara fillimit të aplikimeve për pranimet në ciklin e parë të studimeve.</i> <i>UGJ respekton kuadrin rregullator në fuqi lidhur me pranimin e kandidatëve me aftësi të veçanta, pakicave, shtresave në nevojë dhe kandidatëve nga shtete të tjera; si dhe merr vendime për aplikimin e bursave dhe tarifave të reduktuara për studentët cilësorë dhe nga shtresa në nevojë sipas legjislacionit në fuqi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqërues, si dhe në takimet gjatë vizitës në UGJ, GVJ konstatoi se në dispozicion të studentëve vihet informacion i plotë lidhur me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të tyre si dhe lidhur me procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparëshme në rast transferimi të studimeve. Rregullorja e UGJ dhe Rregullorja e studimeve
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të	UGJ japin informacion lidhur me procedurat dhe dokumentacionin e nevojshëm për njohjen dhe ekuivalentimin e diplomave dhe periudhave të mëparshme të studimit. Në përputhje me Ligjin 80/2015 të Arsimit të Lartë, Statutin e UGJ- Neni 72, Rregulloren e Universitetit – Neni 65 dhe

mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Rregulloren e FE- Nenet 30, 31, Sekretaria Mësimore dhe Departamenti KF, kanë për detyrë të informojnë të gjithë të interesuarit, që dëshirojnë të transferojnë studimet nga një universitet tjetër në UGJ, apo të transferojnë kreditet e marra gjatë zhvillimit të një semester Erasmus në një vend të BE. <i>Evidenca 1.1: Statuti i UGJ;</i> <i>Evidenca 1.2: Rregullore e UGJ;</i> <i>Evidenca 1.6: Rregullore e NJBKF;</i> <i>Evidenca 1.9: Rregullore e programit të studimit Bachelor në Kontabilitet Financë;</i> <i>Evidenca 1.4: Rregullore e studimeve UGJ;</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	GVJ konstaton se në kuadrin rregullator të UGJ jepet informacion i plotë mbi vlerësimin e vazhduar dhe vlerësimin e provimit të zhvilluar për lëndën në përfundim të semestrit. Programet e lëndëve (syllabuset) janë të hartuara në bazë të rregulloreve të institucionit dhe udhëzimit të MAS dhe përmbajnë kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve në këtë program studimi. Këto kriteret dhe procedura u komunikohen studentëve nga pedagogët gjatë orës së parë të mësimi, ku u paraqitet programi i lëndës. <i>Evidenca 1.2 Rregullore e UGJ;</i> <i>Evidenca 1.6: Rregullore e NJBKF;</i> <i>Evidenca 1.9: Rregullore e programit të studimit Bachelor në Kontabilitet Financë;</i> <i>Evidenca 1.4: Rregullore e studimeve UGJ;</i> <i>Evidenca II.28 dhe II.28.1: Silabuset e lëndëve;</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Në Rregulloren e Studimeve të UGJ, Departamenti përgjegjës për programin e studimit vë në dispozicion të studentëve të vitit të fundit: ▪ programin e provimit të formimit; ▪ temat orientuese të diplomave si dhe udhëzime për procedurat e përgatitjes të temës së diplomës në bachelor; Në takimin me studentët e këtij programi studimi, GVJ konstatoi se studentët ishin të mirë informuar mbi të gjithë procesin e diplomimit në ciklin bachelor, me provim përfundimtar ose me temë diplome. <i>Evidenca 1.2 Rregullore e UGJ;</i>

	<i>Evidenca 1.6: Rregullore e NJBKF;</i> <i>Evidenca 1.9: Rregullore e programit të studimit Bachelor në Kontabilitet Financë;</i> <i>Evidenca 1.4: Rregullore e studimeve UGJ;</i> <i>Evidenca II.28 dhe II.28.1: Silabuset e lëndëve;</i>			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Në përgjithësi, UGJ përmes zyrave përkatëse dhe stafit akademik, angazhohet në informimin e kandidatëve për këtë program studimi.			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se UGJ vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqërues, si dhe në takimet gjatë vizitës në UniBa, GVJ konstatoi se informimi i studentëve mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve bëhet në rregulloret përkatëse të UGJ, në faqen zyrtare në internet, në takimin prezantues me drejtuesit e UGJ dhe personelin akademik në ditën e parë të mësimit për vitin akademik.
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për	Departamenti përgjegjës për programin e studimit vë në dispozicion të studentëve planin mësimor dhe programet e lëndëve, ku paraqitet informacioni mbi përmbajtjen dhe

lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	veprimtaritë formuese të programit të studimit. Gjatë orës së parë të çdo lënde, pedagogët njohin studentët me objektivat e lëndës, njohuritë që do të marrin në lëndën përkatëse, literaturën ku do të mbështeten dhe mënyrën e vlerësimit të njohurive. <i>Evidenca 1.1: Statuti i UGJ;</i> <i>Evidenca 1.2: Rregullore e UGJ;</i> <i>Evidenca II.111: Plan i Mësimor Bachelor në Kontabilitet Financë;</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Bazuar në RVB dhe në vizitën në institucion, GVJ konstatoi se Fakulteti i Ekonomisë ka dhe lidh marrëveshje në vazhdimësi me institucione për të mbështetur studentet e tyre gjatë praktikave dhe mbi të gjitha për t'iu ofruar mundësi punësimi, pavarësisht se GVJ i konsideron të pakta. Gjatë takimit me përfaqësues të zyrës së Karrierës dhe Fakultetit, GVJ u njoh me disa aktivitete që organizohen në kuadër të orientimit të studentëve në tregun e punës, por që mbeten të pakta. Përpjekjet janë më shumë në nivel ndërpersonal pedagogë-student. <i>Evidenca II.19: të dhëna statistikore nga zyra e alumnit;</i>
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	GVJ konstatoi se informimi i studentëve lidhur me zhvillimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën, etj, kryhet kryesisht përmes sekretarisë mësimore si dhe pedagogëve të Departamentit të Kontabilitet Financës. Kjo gjë gjykohej deri diku e mjaftueshme për numrin e vogël të studentëve të këtij universiteti publik.
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	GVJ konstatoi se sistemi i menaxhimit të brendshëm të informacionit, kufizohet vetëm në përdorimin e email-eve të pedagogëve dhe komunikimit përmes sekretarisë mësimore.




Konkluzione	<i>GVJ konstaton përpjekje shumë të mëdha të studentëve në nivel marrdhënie pedagog-student. Por UGJ duhet të bëjë më shumë funksionale zyrat e tjera përgjegjëse për ofrimin e këtyre shërbimeve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																						
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Bazuar në informacionin në RVB dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se UGJ mban dhe disponon statistika vjetore mbi numrin e studentëve të regjistruar dhe diplomuar sipas programeve dhe cikleve të studimit. Konkretisht, sekretaria mësimore në bashkëpunim edhe me departamentet përgjegjëse, administron të gjithë informacionin lidhur me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim për çdo program studimi.																						
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	<table><tr><th>Emri i progra mit</th><th>Viti Akadem ik</th><th>Studentë të regjistru ar</th><th>Nota mesata re ne hyrje</th><th>Studen të të trasfer uar</th><th>Studen të të diplom uar</th></tr><tr><td rowspan="3">Bsc Kontab ilitet - Financ ë</td><td>2020-2021</td><td>37</td><td>6.5</td><td>6</td><td>39</td></tr><tr><td>2021-2022</td><td>36</td><td>76.5</td><td>1</td><td>28</td></tr><tr><td>2022-2023</td><td>35</td><td>6.5</td><td>2</td><td>8</td></tr></table> <i>Evidenca 1.2: Rregullore e UGJ;</i> <i>Evidenca 10: Rregullore e Sekretarisë;</i> <i>Evidenca 16: Rregullore e njësuar për punën me dokumentate UGJ;</i> <i>Evidenca 4.1: Aneks i RVB tabela 21 dhe 23;</i>	Emri i progra mit	Viti Akadem ik	Studentë të regjistru ar	Nota mesata re ne hyrje	Studen të të trasfer uar	Studen të të diplom uar	Bsc Kontab ilitet - Financ ë	2020-2021	37	6.5	6	39	2021-2022	36	76.5	1	28	2022-2023	35	6.5	2	8
Emri i progra mit	Viti Akadem ik	Studentë të regjistru ar	Nota mesata re ne hyrje	Studen të të trasfer uar	Studen të të diplom uar																		
Bsc Kontab ilitet - Financ ë	2020-2021	37	6.5	6	39																		
	2021-2022	36	76.5	1	28																		
	2022-2023	35	6.5	2	8																		

[Signature]

Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Bazuar në informacionin e RVB dhe në vizitën në institucion, GVJ konstatoi se ruajtja dhe menaxhimi i të dhënave statistikore të studentëve realizohet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe kërkesat e statutit dhe rregulloreve të UGJ dhe Fakultetit. Zyra e Sekretarisë Mësimore kujdeset drejtpërdrejt për ruajtjen e informacionit në formatin letër (regjistrat e sekretarisë mësimore, procesverbalet e provimeve & dosjet personale të studentëve) dhe në versionin elektronik (në sistemin e brendshëm informatik PITAGORA). <i>Evidenca 4: RVB;</i> <i>Evidenca 10: Rregullore e Sekretarisë;</i> <i>Evidenca 16: Rregullore e njësuar për punën me dokumentate UGJ;</i>
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njërive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqërues, si dhe në takimet gjatë vizitës në UGJ, GVJ konstatoi kontrollin sipërfaqësor dhe jo të dedikuara lidhur me kontrollin periodik pranë strukturave që merren me menaxhimin apo ndonjë vlerësim periodik të saktësisë së informacionit dhe dokumentacionit që lidhet me studentët dhe veprimtarinë përkatëse. <i>Evidenca I.13.1deri 3 Raporti i veprimtarisë mësimore shkencore në NJ.B.K-F;</i>
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	UGJ, bazuar në udhëzimet e MAS harton raportet vjetore, me një format standard dhe një nga rubrikat i referohet të dhënave të studentëve për çdo program studimi. <i>Evidenca I.13.1deri 3 Raporti i veprimtarisë mësimore shkencore në NJ.B.K-F;</i>



Konkluzione	<i>GVJ konstaton se UGJ mbledh, administron, përfitëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre, kryesisht përmes sekretarisë mësimorë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se UGJ në përputhje me legjislacionin në fuqi, statutin dhe rregulloren e institucionit ka mundësuar ngritjen e Këshillave Studentore në nivel Fakulteti si dhe angazhimin e përfaqësuesve të studentëve në Senatin Akademik të USH, dhe në Bordin e Administrimit.
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	GVJ konstatoi se në statutin e UGJ parashikohen dhe këshillat e studentëve me qëllim garantimin e përfshirjes së studentëve në procesin e vendimmarrjes me përfaqësuesit e tyre të zgjedhur në një proces transparent.
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit,	Përveç përfshirjes së studentëve në vendimmarrje, përmes strukturave të përcaktuara në kuadrin rregullator të UGJ, GVJ konstatoi se institucioni përdor edhe formularët për studentët (pyetësorët) për vlerësimin e procesit akademik dhe të

rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	personelit pedagogjik sipas lëndëve, programeve dhe cikleve të studimit që ata ndjekin. Gjithashtu GVJ konstatoi se kuadri rregullator i UGJ sanksionon të drejtën e studentëve për t'u përfaqësuar dhe patur rol në vendimarrje. <i>Evidenca 1.1: Statuti i UGJ;</i> <i>Evidenca 1.2: Rregullore e UGJ;</i> <i>Evidenca V.13.1: Urdhër për ngritjen e GVB për Këshillin Studentor;</i> <i>Evidenca 4.1: RVB, Tabela 24 të dhëna për anëtarët e NJSBC;</i>			
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Bazuar në dokumentacionin e DVV, RVB dhe në takimin me stafin dhe studentët e UGJ, GVJ konstatoi se në cdo fund semestri studentët kanë mundësi të reflektojnë dhe paraqesin vlerësimet e tyre mbi procesin mësimorë dhe procesin e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve me anë të pyetësorëve të cilët mund ti plotësojnë për çdo lëndë dhe pedagog. <i>Proces ky që nuk është shumë i qartë dhe fiks për të gjitha lëndët, pasi nga takimi me stafin akademik, GVJ konstatoi dhe iniciativa personale të personelit për lëndët e tyre pasi informacioni i mbledhur nga pyetësorët nuk ka pjesëmarrje të lartë apo komente konkrete.</i>			
Konkluzione	GVJ konstatoi se UGJ ka mundësuar angazhimin e përfaqësuesve të studentëve në Senatin Akademik, në Bordin e Administrimit si edhe pranë GVB të këtij programi studimi, në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të	GVJ konstatoi se rregullorja e Fakultetit Ekonomik parashikohen qartë procedurat dhe strukturat e dedikuara në shërbim të studentëve si Sekretaritë Mësimore që janë në

informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	funksione administrative nën njësinë kryesore dhe Zyra e Këshillimit dhe Karrierës dhe Alumni në UGJ. <i>Evidenca 1.1: Statuti i UGJ;</i> <i>Evidenca 1.2: Rregullore e UGJ;</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Sekretarët dhe Zyra e Karrierës garantojnë informimin, këshillimin dhe ndjekjen e ecursisë së studentëve sipas programeve të studimit në nivel Fakulteti dhe në nivel Universiteti; si edhe kontribuojnë me të dhëna statistikore e duke ndjekur në tërësi problematikat e lidhura me studentët. <i>Evidenca V.13 :Formular për gjurmimin e studentëve;</i> <i>Evidenca II.19: Të dhëna statistikore nga Zyra e Alumnit;</i> <i>Evidenca II.18: Database Alumni;</i> <i>Evidenca IV.5: Rregullore për funksionin e DSHNA; Evidenca V.13.2: Plani vjetor për këshillimin e karrierës; Evidenca V.13.1: Korrespondenca për këshillimin e karrierës;</i>
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Gjithashtu, Zyra e Karrierës ka për detyrë të mbështesë studentët e diplomuar në mënyrë që ata të orientohen dhe të përshtaten më mirë në tregun e punës. Për këtë qëllim, zyra mbledh të dhëna për të diplomuarit përmes pyetësorit për studentët alumni dhe mban një bazë të dhënash, si dhe ndjek integrimin e tyre në tregun e punës dhe mban kontakte me studentët e diplomuar me qëllim bashkëpunimin në shërbim të programeve të studimit. <i>Evidenca V.13 :Formular për gjurmimin e studentëve;</i> <i>Evidenca II.19: Të dhëna statistikore nga Zyra e Alumnit;</i> <i>Evidenca II.18: Database Alumni;</i> <i>Evidenca IV.5: Rregullore për funksionin e DSHNA; Evidenca V.13.2: Plani vjetor për këshillimin e karrierës; Evidenca V.13.1: Korrespondenca për këshillimin e karrierës;</i>
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion	Gjithsesi, GVJ konstatoi se zyra e Karrierës në bashkëpunim me fakultetet në USH, gjurmon punësimin e studentëve të diplomuar, dhe kjo mbështet shumë nga puna individuale e pedagogëve.

studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.				
Konkluzione	<i>UGJ ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët" vlerëson që ka vend për më shumë dinamikë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Nga vlerësimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, dhe konkretisht: Strategjia për përmirësimin e cilësisë, dhe Udhëzues institucional mbi metodat inovative të mësimdhënies, si dhe nga takimet me stafin, vërehen përpjekje për përmirësimin e cilësisë së procesit mësimor dhe përmirësimin e metodave të mësimdhënies. Gjatë pandemisë, lindi si nevojë hartimi në nivel instiucional i udhëzuesit për përdorimin e platformave online, si Microsoft Teams, etj. Gjithashtu nga dokumentacioni vërehet urdhri për përdorimin e platformës Learning Key. <i>Gjithsesi konsidertohen të pjesshme përpjekjet për metoda të ndryshme innovative në mësimdhënie në nivel institucional.</i> <i>Evidenca III.1: urdhër për përdorimin e platformës online; Evidenca III.5: Udhëzues institucional mbi metodat inovative të mësimdhënies;</i>

	<i>Evidenca III.5.2: Strategjia për përmirësimin e cilësisë;</i> <i>Evidenca IV.13: Urdhër për përdorimin e platformës Learning Key;</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Në mbështetje të Ligjit 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, nenit 103 të Statutit të UGJ, Senati Akademik i UGJ me Vendimin nr. 24, datë 28.09.2023 “Për miratimin e NJSBC”, ka përcaktuar përbërjen e NJSBC. UGJ ka dy struktura bazë për kontrollin dhe garantimin e cilësisë së mësimdhënies: Njësia e Sigurimit të Cilësisë dhe Sektori i Standardeve, Cilësisë dhe Kurrikulave. SSCK përmes një tërësie procedurash organizon një sërë veprimtarish vjetore që në thelbin e tyre synojnë monitorimin, vlerësimin dhe promovimin e cilësisë, përmes instrumentave statistikore, database-t mbi vlerësimin semestral dhe vjetor të pyetësorëve të studentëve, raporte të ndryshme analitike, etj. Gjatë vizitës në institucion dhe nga takimet me stafin, u vunë re përpjekje të institucionit për të hartuar strategji, raporte vjetore, por GVJ konstaton se nevojitet ende shumë punë në zbatimin e tyre dhe krijimin e një procesi monitorues të cilësisë së mësimdhënies. <i>Evidenca III.5.2: Strategjia për përmirësimin e cilësisë;</i> <i>Evidenca I.1: Statuti i UGJ; Evidenca VI.4. Rregullorja NJSBC;</i> <i>Evidenca VI.3 dhe VI.3.1: Raport vjetor i SSCK 2021-2022 dhe 2020-2021;</i> <i>Evidenca VI.3.2: Plani vjetor i SSCK;</i>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimin të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Kuadri rregullator i UGJ u mundëson studentëve që në fund të çdo semestri të shprehin mendimin e tyre nëpërmjet plotësimit të një formulari në formë anonime. Gjithashtu format e vlerësimit përmbajnë edhe: pyetësor për studentët për programin e studimit; pyetësor për studentet që kanë perfunduar studimet në UGJ në lidhje me kënaqësinë e studentit në program dhe universitet; pyetësor për punëdhënësit, formular vlerësimi i personelit akademik i cili zhvillohet në fund të çdo viti akademik nga drejtuesi i njësive bazë. Por GVJ konstaton se duhen bërë më shumë përpjekje nga SSCK për të përmbushur misionin dhe objektivat e saj. <i>Evidenca I.1: Statuti i UGJ;</i> <i>Evidenca VI.4. Rregullorja NJSBC;</i> <i>Evidenca III.6: Pyetësorët për studentët;</i>

	<i>Evidenca III.7: Raport i SCBC mbi rezultatet e pyetësorit të studentëve;</i> <i>Evidenca VI.3 dhe VI.3.1: Raport vjetor i SSCK 2021-2022 dhe 2020-2021;</i>			
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, dokumentacionin shoqërues, si dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në UGJ, GVJ konstatohet se puna e vetme e kryer në drejtim të monitorimit të cilësisë ishte pyetësori drejtuar studentëve dhe rezultatet e marra prej tij. Gjithashtu GVJ nuk konstatohet ndonjë shembull promovimi të praktikave pozitive me qëllim nxitjen e personelit akademik për përmirësim të mëtejshëm në mësimdhënie.			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	<i>Evidenca III.7: Raport i SCBC mbi rezultatet e pyetësorit të studentëve;</i> <i>Evidenca VI.3 dhe VI.3.1: Raport vjetor i SSCK 2021-2022 dhe 2020-2021;</i>			
Konkluzione	<i>Nga vizita në institucion dhe nga reflektimi i dokumentacionit, GVJ konstaton se UGJ ende ka shumë punë për të bërë drejt konsolidimit të strategjisë dhe mjeteve të sigurimit të cilësisë, si dhe zbatimit me rigorozitet dhe eficiencë të tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me	Në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore, nenin 94 të Statutit të UGJ, Vendimit të Senatit Akademik nr. 24, datë 28.09.2023 "Për miratimin e NJSBC", Komisioni i Përhershëm në Nivel Institucional për Garantimin e Standardeve të Cilësisë të Institucionit dhe Programeve të Studimit miraton formatin dhe modalitetet e pyetësorit institucional të studentëve.

aktet rregullatore institucionale.	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë evidenton dhe ndjek problematikat e lidhura me cilësinë e mësimdhënies; bën vlerësimin periodik të rezultateve të veprimtarive mësimore dhe kërkimore shkencore; organizon dhe ndjek zhvillimin e pyetësorit studentor institucional dhe pyetësorit për cilësinë e mësimdhënies për çdo program studimi. Por <i>GVJ vlerëson që duhet të bëhen më shumë përpjekje për të hartuar matës eficientë së cilësisë për monitorimin e vazhdueshëm të cilësisë.</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	<i>Nevojitet më shumë punë drejt plotësimit të qëllimeve dhe objektivave në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së aktivitetit akademik dhe kërkimor që përfshijnë bashkëpunimin me studentët dhe bashkëpunëtorë të jashtëm.</i> <i>Evidenca I.1: Statuti i UGJ;</i> <i>Evidenca VI.4: Rregullorja NJSBC;</i> <i>Evidenca III.6: Pyetësorët për studentët;</i> <i>Evidenca III.7: Raport i SCBC mbi rezultatet e pyetësorit të studentëve;</i> <i>Evidenca I.3: Strategjia e zhvillimit të UGJ 2020-2025;</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Nga takimet në IAL, si dhe dokumentacioni i vënë në dispozicion, GVJ konstatoi se më shumë praktika duhen dokumentuar dhe institucionalizuar dhe se proceset e akreditimit janë një mënyrë për të nxitur IAL-në në këtë drejtim dhe ata e konsiderojnë shumë pozitive praktikën e krijuar në këtë akreditim të parë të programeve. <i>Ende ka shumë punë drejt forcimit të instrumentave të vlerësimit të cilësisë dhe zbatimit me përgjegjshmëri të tyre.</i> Aktualisht përdoret vetëm pyetësori i studentëve, dhe nuk ka instrumenta të tjerë. UGJ i është nënshtruar riakreditimi institucional në vitin 2021, rekomandimet e dhëna nga Bordi i Ascal-it evidentojnë se strukturat e IAL duhet të bëjnë përpjekje në disa drejtime për të përmirësuar cilësinë e proceseve në të. <i>Evidenca I.21: Vendimi i akreditimit institucional periodic;</i>
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet	GVJ vlerëson se në rregulloret dhe manualët e UGJ dhe FE paraqitet qartë politika e institucionit lidhur me sigurimin dhe përmirësimin periodik të cilësisë së programeve të studimit. Vlerësimi i cilësisë në mësimdhënie sigurohet nëpërmjet pyetësorit të studentit i cili vlerëson performancën e stafit akademik të angazhuar në mësimdhënie.

regullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.				
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson që duhet të bëhen më shumë përpjekje për të hartuar matës eficientë të cilësisë për monitorimin e vazhdueshëm të cilësisë. Nevojitet më shumë punë drejt plotësimit të qëllimeve dhe objektivave në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së aktivitetit akademik dhe kërkimor që përfshijnë bashkëpunimin me studentët dhe bashkëpunëtorë të jashtëm.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, dokumentacionin shoqërues, si dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në UGJ, GVJ konstatoi përdorimin e pyetësorëve të studentëve, por nuk ka praktikë për përfshirjen e rezultateve për të motivuar apo marrë masa të caktuara në vijim të përmirësimit të cilësisë. <i>GVJ rekomandon dhe instrumenta alternativë, si fokus grupet, mbledhjet e hapura të departamentit me studentët, tryezat me industrinë etj.</i> <i>Evidenca III.7: Raport i NJSBC mbi rezultatet e pyetësorit të studentëve;</i> <i>Evidenca VI.3 dhe VI.3.1: Raport vjetor i SSCK 2021-2022 dhe 2020-2021;</i> <i>Evidenca I.11.6: Raport vjetor i UGJ 2021-2022;</i> <i>Evidenca VI.3 dhe VI.3.1: Raport i veprimtarisë mësimore shkencore të FE viti 2020-2021;</i>

autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	GVJ konstatoi nga RVB se në nivel institucional, NJSBC realizon çdo vit akademik Raportin e Vlerësimit të Brendshëm i cili paraqet një studim të funksionimit institucional të UGJ-së dhe përmblidhjen e standardeve të cilësisë për vitin akademik. Ky raport përmbledh evidencat me anë të së cilave vlerësohet përmblidhja e standardeve të cilësisë e veprimtarive akademike dhe mësimore mundëson analizimin e nevojave dhe vendosjen e synimeve për zhvillimin e cilësisë.
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	Përpos realizimit të pyetësorit të studentëve, UGJ realizon vlerësimin e cilësisë së programit të studimit të studentëve sa i përket psh mesatares në hyrje dhe dalje, punësimit të tyre etj. Ndërkohë që kryejnë testime paraprake dhe përfundimtare; provime për modulet, praktikë; vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët; vëzhgime gjatë kryerjes së praktikës; leksioneve të hapura etj, për mbarëvajtjen e cilësisë së programit të studimit. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, RVB dhe vizita në IAL përveç anketimit të studentëve në lidhje me cilësinë e mësimdhënies, nuk evidentohen metoda të tërthorta vlerësimi si sondazhe, intervista të hapura, fokus grupe etj. <i>GVJ sugjeron kryerjen e sondazheve por edhe aplikimin e planeve të veprimeve në rast të evidentimit të mangësive, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit.</i> <i>Evidenca I.11.6: Raport vjetor i UGJ 2021-2022;</i> <i>Evidenca VI.3 dhe VI.3.1: Raport i veprimtarisë mësimore shkencore të FE viti 2020-2021;</i>
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e	

instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.				
Konkluzione	GVJ konstaton se: UGJ përdor pyetësorët, realizon vlerësimin e cilësisë së programit të studimit të studentëve sa i përket psh mesatares në hyrje dhe dalje, punësimit të tyre por raportet e strukturës së NJSBC nuk përfshin plan masash për përmirësimin e gjetjeve dhe rekomandime për promovimin e praktikave pozitive.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	


Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në takimet gjatë vizitës në UGJ, GVJ konstatoi se në faqen web zyrtare të institucionit ka një hapësirë të dedikuar mbi sigurimin e cilësisë me qëllim informimin e studentëve dhe të gjithë të interesuarve. Aty publikohet informacioni mbi strukturat e sigurimit të cilësisë në UGJ, Akreditimi institucional, Raporti



për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	auditit dhe buxheti, Si dhe programi i transparencës që përmban informacione/raporte. GVJ vëren se publikimi i rezultateve të vlerësimit të programit të studimit bëhet në përputhje me ligjin dhe aktet e UGJ.
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	GVJ konstaton se informacioni i paraqitur në këto raporte respekton lirinë dhe etikën akademike, si dhe ruan privatësinë e informacionit në përputhje me legjislacionin për të dhënat personale. <i>Evidenca VI.3: Raporti vjetor i SSCK 2020-2021;</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.	Siç u përmend edhe në kriteret 1 & 2 të Standardit VI.3, GVJ konstatoi se raportet e NJSBC kryesisht bëjnë një paraqitje përshkruese të proceseve dhe gjetjeve të tyre, por nuk përfshijnë një plan masash konkret për përmirësimin e problematikave. <i>GVJ rekomandon që në raportet e strukturës së NJSVC të përfshihet edhe një plan masash për përmirësimin e gjetjeve si dhe rekomandime për promovimin e praktikave pozitive.</i> <i>Evidenca VI.3: Raporti vjetor i SSCK 2020-2021;</i>
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Nga takimi në institucion dhe raporti RVB, GVJ konstaton se po bëhen përpjekje në drejtim të këtij procesi të rëndësishëm, por ende ka shumë punë për të bërë. Staf i është i ndërgjegjësuar për rëndësinë e procesit të vlerësimit, por edhe rëndësinë e kryerjes me kujdes të këtij procesi drejt ruajtjes së integritetit dhe mosdiskriminimit të personelit dhe të studentëve.
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose	GVJ konstaton se UGJ ka lidhur një sërë marrëveshesh bashkëpunimi me institucione të ndryshme, nga të cilat mundohet të përfitojë edhe në kuadër të konsultimeve për rritjen e cilësisë së programeve të studimit që ofron.



ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vjera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	<i>Gjithashtu, GVJ rekomandon që në ndihmë mund të vijë dhe përfshirja e bashkëpunëtorëve apo ekspertëve të jashtëm, e cila mungon.</i>			
Konkluzione	<i>Kuadri rregullator kryesor i UGJ, Statuti dhe Rregullorja e tij, përcaktojnë organet që përfshihen në procesin e sigurimit dhe përmirësimit të vazhduar të cilësisë së programit të studimit. Por UGJ duhet të sigurojë përfshirjen dhe aktivizimin e personelit akademik dhe të studentëve në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së programit të studimit.</i> <i>Përfshirja e bashkëpunëtorëve apo ekspertëve të jashtëm në procesin e vlerësimit të cilësisë mund të realizohet kryesisht përmes takimeve të hapura dhe aktiviteteve të përbashkëta.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Në faqen zyrtare të internetit të UGJ, ne menune e transparencës gjenden dokumentat e mëposhtëm: - Akreditimi institucional; - Përbërja e NJSBC – koordinatori institucional; - Raporti auditit dhe buxheti; Si dhe programi i transparencës që përmban informacione/raporte. Etj në shërbim të publikut, stafit dhe studentëve.
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në takimet gjatë vizitës në UniBa, GVJ konstatoi se në faqen web zyrtare të institucionit publikohen rezultatet e vlerësimit të programit të studimit në përputhje me ligjin dhe aktet e UGJ. Nga



legjislacionin për të dhënat personale.	shqyrtimi i raporteve të publikuar në faqen e UGJ, nuk rezulton që të jetë çënuar liria akademike apo të dhënat personal.			
	<i>Evidenca VI.3: Raporti vjetor i SSKC 2020-2021;</i>			
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Në tërësinë e dokumentacionit të paraqitur në platformën e ASCAL, RVB rezulton që UGJ ka formuluar një plan masash për akreditimin institucional dhe një vendimarrje të Senatit akademik për këtë plan masash. Ndërkohë Raporti vjetor i SSKC është analitik, ai konstaton por nuk mban qëndrim dhe nuk përcakton një plan masash për institucionin. <i>Evidenca VI.3: Raporti vjetor i SSKC 2020-2021;</i> <i>Evidenca I.29: Plani i veprimit për akreditimin institucional;</i>			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Nga takimi në institucion dhe raporti RVB, GVJ konstaton se po bëhen përpjekje në drejtim të këtij procesi të rëndësishëm, por ende ka shumë punë për të bërë në drejtim të përmirësimit të procesit të sigurimit dhe përmirësimit të cilësisë.			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	GVJ vëren se institucioni mund të ketë organizuar veprimtarinë relativisht periodike me personelin dhe me studentët me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin për sigurimin e përmirësimit të cilësisë së programit të studimit. Por UGJ duhet të sigurojë përfshirjen dhe aktivizimin e personelit akademik dhe të studentëve në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së programit të studimit.			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson që IAL duhet të bëjë përpjekje të vazhdueshme për të përmirësuar procesin e vlerësimit dhe monitorimit të cilësisë së programit të studimit i cili akreditohet për herë të parë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Kontabilitet Financë”

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Programi i studimit është konkurrent dhe garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuar sipas kërkesave të tregut të punës dhe mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve të thelluara në cikle studimi më të larta;
2. Infrastruktura që ofron institucioni në shërbim të programit të studimit është e përshtatshme dhe me mjedise të pajisura me mjetet dhe teknologjinë e nevojshme për të garantuar cilësinë në mësimdhënie dhe mësimnxënie;
3. Stafit akademik i angazhuar në programin e studimit bën përpjekje maksimale për mbarrëvajtjen e programit të studimit, në ndjekjen e studentëve gjatë këtij programi, në realizimin e praktikës si dhe në daljen në treg të tyre;
4. Institucioni angazhohet në nxitjen e stafit akademik dhe studentëve për të marrë pjesë në mobilitete dhe projekte kërkimore dhe shkencore;

b. Pika të dobëta:

1. Mungesa e një lënde “Praktikë Profesionale” që të zhvillohet pranë bizneseve apo institucioneve bashkëpunuese për të afruar studentët me tregun e punës; (*Standardi III.4, kriteri 1*)
2. Tekstet e lëndëve për literaturën bazë ashtu dhe për atë të rekomanduar të vendosur në silabuset e lëndëve janë të vjetërsuara dhe nuk i përkasin 5 viteve të fundit; (*Standardi IV.3, kriteri 1*)
3. Personeli akademik i NJBKF është i ngarkuar dhe se ka pedagogë që zhvillojnë më shumë lëndë se sa lejon VKM 29, datë 10.09.2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të stafit akademik në IAL”; (*Standardi III.1, Kriteri 4*)

Rekomandime:

1. Të shtohet lënda e "Praktikës Profesionale" në planin mësimor duke hartuar edhe syllabusin përkatës;
2. Konstatohet një vjetërsim i literaturës dhe për këtë rekomandohet përditësim i saj, duke forcuar marrëveshjet ekzistuese dhe lidhjen e marrëveshjeve të reja, si dhe mundësinë përmes projekteve (meqënëse buxheti është shumë i limituar) për përmbushjen e këtij standardi. Institucioni duhet të intensifikojë punën për të rritur bashkëpunimet me IAL të tjera brenda e jashtë vendit, por edhe me biznese, institucione publike dhe private;
3. Duhet të bëjë përpjekje nga institucioni për të patur programe studimit të përbashkëta, të cilat shtojnë mundësitë e integritit si për studentët edhe për personelin akademik;
4. Njesia Bazë Kontabilitet Financë duhet të bëjë përpjekje për angazhimin e një numri më të madh pedagogësh nga kategoria "Profesor", për të ulur edhe ngarkesën e stafit akademik;
5. UGJ ende ka shumë punë për të bërë drejt konsolidimit të strategjisë dhe mjeteve të sigurimit të cilësisë, si dhe zbatimit me rigorozitet dhe eficiencë të tyre. Duhet të bëhen më shumë përpjekje për të hartuar matës eficientë të cilësisë për monitorimin e vazhdueshëm të cilësisë. Nevojitet më shumë punë drejt plotësimit të qëllimeve dhe objektivave në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së aktivitetit akademik dhe kërkimor që përfshijnë bashkëpunimin me studentët dhe bashkëpunëtorë të jashtëm;


Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor "Kontabilitet Finance"

a. Strengths and affirmations:

1. The study program is competitive and guarantees the acquisition of targeted knowledge, skills and competences according to the requirements of the labor market and enables the continuation of in-depth studies in higher study cycles;
2. The infrastructure provided by the institution is suitable and with spaces equipped with the necessary facilities, tools and technology to guarantee quality in teaching and learning;
3. The academic staff engaged in the study program makes maximum efforts for the success of the study program, in following the students during this program, in the realization of the practice as well as in their exit to the market;
4. The institution engages in encouraging academic staff and students to participate in mobilities and research and scientific projects;

b. Weaknesses:

1. Lack of a "Professional Practice" course to be carried out at cooperating companies or institutes to bring students closer to the job market; (*Standard III.4, criterion 1*)



2. The course texts for the basic literature as well as for the recommended one placed in the course syllabi are outdated and do not belong to the last 5 years; (*Standard IV.3, criterion 1*)
3. The academic staff of the Accounting and Finance Basic Unit is overloaded and that there are lecturers who develop more subjects than allowed by VKM 29, dated 10.09.2018 "On the activity and teaching load of the academic staff in HEIs"; (*Standard III.1 criterion 4*)

Recommendation

1. Insert the course of "Professional Practice" into the curriculum by drawing up the relevant syllabus;
2. An aging of the literature is established and for this reason its updating is recommended, strengthening the existing agreements and the conclusion of new agreements, as well as the possibility through projects (since the budget is very limited) to fulfill this standard. The institution should intensify its work to increase cooperation with other HEIs inside and outside the country, but also with businesses, public and private institutions;
3. Efforts should be made by the institution to have joint study programs, which increase the integration opportunities for both students and academic staff;
4. The Accounting and Finance Basic Unit should try to engage a greater number of lecturers from the "Professor" category to reduce the workload of the academic staff;
5. UGJ still has a lot of work to do towards the consolidation of the quality assurance strategy and tools, as well as their rigorous and efficient implementation (Standard VI.1, Criterion 2). More efforts should be made to design efficient quality metrics for continuous quality monitoring. More work is needed towards the fulfillment of goals and objectives in function of continuous improvement of the quality of academic and research activity that includes cooperation with students and external collaborators;



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR			X	
VLERËSIMI TËRËSOR				X

